

NE INTERES DHE NE SHERBIM TE KOMUNITETIT

STRATEGJIA
E ZHVILLIMIT EKONOMIK VENDOR
Bashkia Korce

2005 - 2010

PERMBAJTJA

- Parathenie
- Vizioni i Bashkise se Korces
- Situata ekonomike e Bashkise se Korces
- Analiza SWOT e Bashkisë se Korçës
- Zhvillimi i Strategjisë
- Synimet e Strategjisë
- Matrica deri te projektet
- Fishat e projekteve

PARATHENIE

Rajoni I Korces – nje vision per biznesin

I. Background

Rajoni I Korces shtrihet ne pjesen juglindore te Shqiperise,dhe kufizohet ne lindje me dy shtete: Greqine dhe Maqedonine.

Rajoni I Korces ka 4 Bashki: Bashkine ne Korca (qendra e Prefektures), Pogradec,Bilisht and Erseka.

Klima

Klima e Rajonit klasifikohet ne kategorine e trete ne skemen klimaterike te vendit:Mediterane ne zonen malore.Eshte klime kontinentale,karakterizohet nga dimer i ftohte dhe me temperature relativisht te larte gjate veres.

Largesia nga qendrat kryesore te Balkanit

Tirana	180 km
Porti i Durres	200 km
Port i Selanikut ne Greqi	250 km
Skopia	280 km
Prishtina	430 km
Sofia	500 km
Bukuresht	900 km

Siperfaqja	3697 Km ² (ose 12% e siperfaqws totale te Shqiperise)
Popullsija	360.000 banore (ose 10% e totalit te popullsisë se SHqiperise
Nr. I bizneseve	4.000

Universiteti I Korces - institucion I rendesishem ne Rajon qe nxjerr cdo vit specialiste te kualifikuar ne dege te ndryshme te biznesit dhe agronomise.

II. Situata aktuale dhe perspektiva afat mesme

a. Sektorët kryesore të biznesit:

Bujqesia,

Fakti qe Korca ka fushen bujqesore te dyten nga madhesia ne Shqiperi ,e ben kete sektor me te rendesishmin per ekonomine e rajonit me nje volum total ne te ardhurat prej 32%.Fragmentizimi I tokes ne ferma familjare te vogla sjell nivel te ulet te produkteve bujqesore.Kjo pengon perspektiven e specializimit te produkteve bujqesore dhe mekanizimin ne shkalle te larte te bujqesise. Pamundesia e

perdorimit te inpueteve bujqesore ne shtese te fakteve qe u permenden me siper, tregon se fermeret nuk jane ne gjendje te plotesoje nevojat e ekonomise se vendit me prodhime. Si rezultat, produktiviteti i ulet, kosotja e larte dhe cilesija e ulet jane karakterisitikat tipike te produkteve bujqesore ne Shqiperi. Tabloja behet akoma me komplekse nqse u shtojme fakteve te mesiperme natyren ekstremisht sezonale te produkteve bujqesore. Produktet bujqesore vendase jane te pa mjaftueshme; tregu furnizohet vetem per disa muaj ne vit duke krijuar hapesire te lire per importimin e produkteve bujqesore. Per momentin bujqesia nuk i ploteson nevojat e tregut vendas dhe nuk eshte kompetitive per produktet e importuara. Per shkak te klimes se favorshme dhe perdorimit te sasive te vogla te fertilizuesve dhe pesticideve prodhimet bujqesore te rajonit jane te cilesise se larte dhe biologjikisht te pastra- por jo te certifikuara. Per kete arsye ata nuk mund te penetrojne ne treg me vlere te shtuar. Fermat jane larg orientimit nga tregu dhe ne pergjithesi jo mire te organizuara ne shoqata ose kooperativa.

Perspektiva afat mesme e sektorit: Unifikimi i fermave te vogla ne ferma me te medha do te sjelle mundesine e mekanizimit dhe modernizimit te bujqesise. Kjo do te sjelle nje rritje te produktivitetit dhe konkurences te produkteve bujqesore ne rajon. Marreveshja e Tregetise se Lire me shtete e Ballkanit do ti detyroje fermeret qe te gjejne rruge te reja per te mbijetuar ne kete treg nepermjet reduktimit te koston se produkteve dhe identifikimin e produkteve te reja per te cilat kerkesa eshte me e madhe se oferta (luleshtrydhe manafera etj) Nje imput i rendesishem eshte dhene nga programe mbeshetese nga institucione te ndryshme nderkombetare dhe organizata qe operojne ne rajon. Levizja demografike nga fshati ne qytet si dhe ligji per blerjen dhe shitjen e tokes bujqesore jane faktore te rendesishem promovues per krijimin e fermave te madha. Si burimi kryesor natyral i rajonit t, bujqesia do te mbetet domonante ne ekonomine e Rajonit te Korces.

Industria e konfeksioneve

Kjo industri perben rreth 31% te ekonomise rajonale. Eshte dega me e madhe ne kuptimin e numerit te ndermarrjeve, rreth 35 dhe te punesuar rreth 4500 – 5000 (kryesisht) gra. Ne shumicen e rasteve shoqeri te perbashketa Shqiptaro – Greke, kompanite punojne ne sektorin e konfeksioneve. Gjithe lenda e pare vjen nga jashte dhe produktet eksportohen totalisht gjithashtu.

Perspektiva afat mesme e sektorit Per shkak te rritjes se koston sekrahut te punesne Shqiperi ky sektor nuk do te mbetet shume atraktiv per kohe te gjate. Kompanite e huaja porositese priren drejt tregjeve ku fuqiq punetore eshte me e lire. Eshte duke u ulur nga viti ne vit dhe vetem ato kompani qe do mund te krijojne lidhje direkte biznesi me kliente (te medhenj), qe do mund te eliminojne partneret ndermjes greke, kane shansin te mbijetojne. Nje mundesi tjeter per kete sektor mund te jete dhe prodhimi (relativisht i vogel) per tregun vendas. Por kjo do mund te siguroje vertem nje numur te limituar kompanish/ pune

Spektori Agroperpunues

Rajoni i Korces eshte nje nga prodhuesit e e medhenj te mishit dhe sallameve, bulmeteve, pijeve alkalike dhe jo alkalike, perpunimit te kermillit e me tej. Biznesi i agroperpunimit eshte rritur vazhdimisht vitet e fundit. Spektori i industrise ushqimore eshte bere nje faktor i rendesishem i punesimit per Rajonin e Korces. Perpunimi i frutave dhe zarzavateve ,perpunimi i qumeshtit, prodhimi i veres, prodhimi i vajit, mjellit etj. ksnr regjistruar rritje. Shumica e kopanive qe operojne ne kete sektor jane klasifikuar te vogla ose te mesme. Aktualisht ,firmat qe punesojne deri ne pese punonjes perbejne rreth 87% te numrit total te ndermarrjeve, ndersa numri i bizneseve me 6 – 10 te punesuar kane tendence te rriten..

Perspektiva afat mesme e sektorit: *Sektori I agroperpunimit do të jetë një nga prioritetet në strategjinë afat mesme të zhvillimit për rajonin tone, për arsye të egzistencës së burimeve natyrore. Duke u bazuar dhe në lidhjet me zhvillimin e sektorit të bujqësisë, sektori I agroperpunimit ka shansin real të bëhet një lojtar kryesor në shkallë nacionale (Shqipëri) dhe transrajonale (Ballkani).*

Sektori I Ndertimit

Në rajonin e Korçes ka rreth 35 kompani ndertimi, që kryesisht veprojnë në fushën e ndertimeve private dhe ndertime tregëtare, shërbime ndërtimi për projekte publike dhe në prodhimin e materialeve të ndryshme të ndertimit. Disa nga ndërmarrjet e ndertimit kanë krijuar struktura të mireorganizuar dhe përqipen të krijojnë marrëdhënie kooperimi internacionale. Ndertimi ka paraqitur një dinamike të lartë ekonomike dhe përben akoma një potencial të madh për rritjen e ekonomisë dhe punësimit.

Perspektiva afat mesme e sektorit: *Bazuar në rritjen e kërkesës së emigrantëve për tu kthyer në Korçe, tregu i shtëpive për banim do të mbetet i qëndrueshëm në perspektivën afat mesme. Përpjekjet për të reduktuar ekonominë informale do të ulin numrin relativisht të madh të ndërmarrjeve të ndertimit dhe të promovojnë një zhvillim pozitiv të ekonomisë së sektorit të ndertimit. Disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare ndertimi, sidomos në fushën e infrastrukurës janë tashmë të planifikuara për dhe jashtë rajonit të Korçes. Zbatimi i këtyre projekteve është planifikuar për vitet 2004 deri 2008. (p.sh. një rrugë e re Korçe Qafethanë, një fushë e re, Koridori Trafiku të EU Nr VIII etj). Kompanitë lokale të ndertimit që janë në gjendje të rinovojnë teknologjinë e tyre, standartet e cilësiveburimet njerezore dhe të krijojnë partneritete me kompani të huaja me eksperiencë do të kenë shanse të mira për të marrë pjesë me sukses në këto tendera publike në të ardhmenë..*

Sektori I Turizmit

Fale potencialeve turistike të Rajonit dhe zhvillimit të infrastrukurës, kërkesa dhe kapaciteti i hoteleve është ngritur vitet e fundit. Aktualisht janë 10 hotele me rreth 400 shtreter në Bashkinë e Korçes dhe 17 hotele me rreth 520 shtreter në Bashkinë e Pogradecit. Për momentin të ardhurat nga turizmi krijojnë një kontribut të vogël në ekonominë e rrethit të Korçes, por në rrethin e Pogradecit është një faktor i konsiderueshëm ekonomik.

Perspektiva afat mesme e sektorit: *Permireshimi i infrastrukurës dhe investimet në zonat turistike do të sjellin rritje në këtë sektor në rajon. Në vendet fqinje greqi e Maqedoni sektori i turizmit është i zhvilluar mirë dhe shumë konkurrues. Njësor ka një potencial të lartë për turizëm në rajonin e Korçes afat mesëm e afat gjatë*

Investimet e Huaja

Në Rajonin e Korçes operojnë 81 kompani të huaja – këto përbejnë 3.3 % të totalit të kompanive të huaja që operojnë në Shqipëri. Investimet e huaja kanë arritur një shumë prej 30.3 milion Euro për Rajonin (3.7 % të shumës totale të investimeve të huaja në Shqipëri).

b. Infrastruktura

Rrruget: Rajoni I Korçes ka relativisht cilesi te mire dhe ne pergjithesi infrastrukture rrugore te suficente ne krahasim me pjesen tjeter te Shqiperise. Ka projekte ne proces per te investuar per rruget qe lidhin Korçen me pjesen perendimore te Shqiperise (Tirana dhe Porti I Durrësit).

Energjia: Situata energjitike ne Rajonin e Korçes eshte permiresuar ne menyre te shkelqyer pas lidhjes se Rajonit ne nje rreth – rrjeti ne Shkurt 2004. Tani eshte e mundur te kete energji elektrike ne parametra optimale, por akoma ka vartesi nga procedurat operacionale te Kompanise se enrgjise qe eshte akoma prone e shtetit, qe nuk eshte ne gjendje akoma te furnizojë me energji elektrike cdo dite per 24 ore. Brenda 2005 nje projekt tjetër do te zbatohet qe permban rikonstrukcionin e Stacionit te Transformatorit per qytetin e Korçes

Sistemi I furnizimit me uje dhe kanalizimit: Qeveria Gjermane ka zbatuar disa investime te medha ne kete sektor per Rajonin e Korçes. Ne detaje projektet e meposhtme kane permiresuar situaten ne rajon:

- Ndertimi I nje stacioni te ri furnizimi me uje dhe rrjeti I shperndarjes per Korçen,
- Ndertimi I sistemit te kanalizimeve per Korçen,
- Ndertimi I nje stacioni te ri furnizimi me uje dhe sistemi per Pogradecin,
- Ndertimi I nje stacioni te perpunimin e ujrave te zeza ne Pogradec,
- Ndertimi I sistemit te kanalizimeve ne Pogradec

c. Sektori Financiar – Sistemi Bankar

Ka 6 Banka ne Korçe si:	2 Banka Greke (NBG Bank dhe Tirana Bank),
	1 Banke Gjermane (ProCredit Bank),
	1 Banke Turke (BKT),
	1 Banke Austriake (Reiffeisen Bank).
	1 Banke Amerikane (American Bank)

Dy banka te tjera te huaja jane ne perгатitje per te hapur degët te tyre ne Korçe. Bankat jane aktive ne pothuajse te gjitha sherbimet qe nje banke ofron. Konsolidimi I stabiliteti politik ne Shqiperi dhe rajon do te reduktoje nivelin e rreziqeve dhe do kete influence pozitive ne shkallen e interesave bankare per kredi komerciale gjithashtu. Depozitat e banoreve te Korçes jane rreth 100 milion USD. Nje prezantim me intensiv I sektorit bankar dhe sherbimeve bankare per biznesin – vechanerisht per SME-te eshte nje detyre e vazhdueshme dhe e proces I perhereshem per momentin.

d. Programet e Zhvillimit Rajonal

Qeverija Gjermane ka investuar dhe eshte ne proces investimesh ne infrastrukture per rreth 50 milion Euro. Shoqata Qeveritare Suedeze SIDA eshte duke zbatuar 15 projekte per Zhvillimin Rural ne Rajon. Instituti East-West eshte duke koordinuar nje rrjet per krijimin e nje EURORAJONI ne trekendeshin Korçe (Alb.) – Bitola (Mac.) – Kozani (Gr.), qe do te terheqe investime te rendesishme ne Rajon ne baze te nje strategjije Rajonale te perbashket.

Pervec ketyre ka dhe nje numur projektesh te tjera dhe aktivitete te organizatave te ndryshme nderkombetare (p.sh. GTZ, UNPD, SNV, NEHEMIA, Dorcas Aid, Triangel etj.) ne rajon.

Nje plan I zhvillimit rajonal eshte shume I domosdoshem qe te koordinoje gjith aktivitetet ,por nuk eshte bere dhe rene dakort akoma

e. Porjektet me kryesore dhe organizatat donatore, OJQ, etj.

FSHZH – Fondi SHqiptar I Zhvillimit. Aktiviteti I saj financohet nga qeveri te disa vendeve, por kryesisht nga qeverija franceze. Fondet zakonisht jane perdorur per investime ne infrastrukturen bujqesore,sistemin ujites etj.

Islamic Bank – Investon per rehabilitimin e sistemit te ujitjes e drenazhimit, rezervuaret ne fushen e Korces.

- a) GTZ – Mbeshtetja e Sektorit Privat te Ekonomise ne Rajonin Korçe/Pogradec.
- b) SIDA – Swedish International Development Cooperation Agency inveson ndertimin dhe operimin e tregjeve rurale,ceshtje te migrimin, demokratizimit, zhvillimit te sektorit privat etj.
- c) UNDP – Implementon nje projekt ne komuna te rajonit dhe quhet Pastrim dhe Gjelberim
- d) APS – Association for Participation in Development ofron mundesi investimi per prodhim, infrastrukture ne zonat rurale malore.
- e) SNV – Dutch Development Agency eshte aktive ne reabilitimin e sistemeve te ujitjes e kullimit,rezervuareve, rrugeve, etj ne rajonin e Korces.
- f) MADA – Mountain Areas Development Agency.
- g) Land O’ Lakes – Asistohet nga USAID per zhvillimin e industrise se perpunimit te qumeshtit.
- h) Agrinas – Agjensija per investimet ne pyjet.

Vizioni

Sektori prioritar I zhvillimit ekonomik do te jete agrobiznesi (perpunimi ushqimor), I mbeshtetur nga nje bujqesi moderne e mireorientuar ne treg dhe konkurese.

Perpunimi ushqimor eshte relativisht nje praktike e re ne Shqiperi. Deri ne mes te viteve ‘50 agrobiznesi shqipetar per behej nga nje numur mullinjsh, furra buke dhe perpunim qumeshti.Ndermarrjet vendase te agrobiznesit u krijuan pas viteve’70. Ne fillimet e ‘90industria agro perpunuese¹ perfshinte afro 200 ndermarrje te medha,me shume se 600 fabrika dhe 600 furra buke. Sasite dhe asortimentet kurre nuk u perputhen me kerkesat e zhvillimit te bujqesise, dhe kerkeses se popullsise per ushqime.

Si rezultat I transformimeve pas vitit 1991, industria agro perpunuese ndermori transformime rrenjesore gjithashtu, dhe u shnderua ne sektor privat. Sot kjo industri eshte pothuajse private totalisht. Agrobiznesi eshte nje nga komponentet me te rendesishem te zhvillimit ekonomik ne Rajon. Duke iu referuar statistikave te fundit, ndryshimet nefurnizimin e produkteve ushqimore jane rezultat i arritjeve ne industrine agroperpunuese, vecanerisht ne disa nga drejtimet e saj.

Arritjet dhe problemet e lidhura me procesin e permbushjes se kerkesave te popullsise per ushqime, dhe nje sere problemesh te tjera si: permiresimi I balancit import – eksport, inkurajimi per orientim ne drejtim te

orientimit nga tregu, rritjen e vleres se shtuar per produktet bujqesoresi rezultat I perpunimit, rritjen e konkurences se produkteve brenda dhe jashte tregut rajonal, rritjen e perqindjes se punesimit, etj, demonstrrojne se zhvillimi I shpejte I agrobiznesit eshte nje problem esencial I zhvillimit te tashem e te ardhem.

Per zhvillimin e ketij sektori ekzistojne jo vetem burrimet vendase te lendes se parepor dhe fuqia punetore e kualifikuar gjithashtu, biles dhe me kosto relativisht te ulet.Ky eshte nje avantazh pozitiv I ketij sektori. Preferenca e larte e konsumatorit shqiptar per produkte vendase dhe imazhi i tyre pozitiv ehste nje avantazh tjetet. Kjo preference eshte e bazuar ne nje numer shume te rendesishem karakteristikash te produkteve bujqesore sic jane freskija,shija, perdorimi I ulet I kimikateve, etj. Nje ekzaminim I kujdeseshem mund te identifikojte nje numer mundesish pozitive zhvillimi gjithashtu, panvaresisht faktit qe ato jane akoma te dobeta.

Ndryshimet lidhur me aktivitetet e marketingut dhe prodhimit ne Shqiperi nuk mund te ndodhin menjehere (sh. Shpejt).Tregu shqiptar do te ofroje oportunitete te mira per nje periudhe kohe per produktet bujqesore nga vendet e tjera te rajonit qe kane marreveshjen per tregetine e lire efektive me Shqiperine ose qe kjo marreveshje do te behet efektive shpejt.

Tregu per produktet e ketij sektori nuk do te jete vetem rajoni dhe tregu kombetar por tregu I Ballkanit dhe me shume. Krijimi I nje tregu te liberalizuar ballkanik eshte nje mundesi dhe sfide per biznesin lokal sepse:

- a) Vendet fqinje kane nje eksperience me te gjate me mallra te tjera. Ato gjithashtu prodhojne mallra me cilesi me te larte dhe zbatojne strategji me te sofistikuara marketingu (p.sh.vera). Duke qene me te hapur karshi konkurences, ata jane fokusuar ne menyre te vazhdueshme ne permiresimin e produkteve te tyre dhe marketingut,gje qe nuk eshte ceshtje kryesore per industrine agroperpunuese ne Shqiperi.
- b) Keto produkte nuk jane perballur me situata te njejta me ato qe karakterizojne tranzicionin shqiptar sic jane jetegjatesija e madhe dhe specifikat e industrise qe sjellin humbjen e eksperiences , pasi rishfaqes se prodhimeve si “diletante” krahasuar me produktet e konsoliduara importuar nga vendet fqinje.

Industri te vecanta varen ne menyre signikative nga lenda e pare e importuar nga vendet fqinje (p.sh. prodhimi I veres, brendit).Kjo situata ne asnje menyre nuk perben avantazh per koston e produkteve shqiptare qe perdorin lende te pare importi, si rezultat I koston se larte te transportit. Ne menyre te vazhdueshme keto produkte kane kosto relativisht te larte dhe perballin nje konkurence te rende me produktet analoge me kosto te ulet nga vendet fqinje. Perdorimi I lendeve te para prej vendeve fqinje sjellin implikime per agroindustrine shqiptare ne lidhje me MTL. Nje shembull specifik mund te permendet Brandy (Kojaku). Ne lidhje me MTL me Maqedonine, konjaku I prodhuar me alkool maqedonas nuk konsiderohet shqiptar sepse perqindja e vleres se shtuar(TVSH) gjate procesit te distilimit nuk e kalon nivelin e kerkuar per produktin me qellimin qe te konsiderohet “me origjine” shqiptare

Burimet e avantazheve te produkteve bujqesore nga vendet e Rajonit (Ballakni) ne tregun e rajonit te Korces jane;

- **Teknologji relativisht moderne.** Keto ekonomi kane pasur nje nivel me te larte te hapjes se ekonomise dhe presion me te larte nga konkurenca qe ka bere te mundur permiresimin e vazhdueshem te konkurences.
- **Ndermarrje me shkalle te larte prodhimi,** qe I lejojne prodhuesit te kene avantazhe ne ekonomine e shkallezuar gjate procesit te prodhimit. Keto rezultate te prodhimtarise se larte sjellin kosto me te ulet prodhimi dhe cmime me te uleta.
- **Sigurimi I Lendes se pare vendase me cmime te pershtateshme.** Industria shqiptare e agroperpunimit perdor lende te para te ketyre vendeve gjithashtu, por cmimet e tyre jane me te larta se ne vendet e tyre te origjines, si rezultat I koston se larte te transportit.
- **Nje ekspertize relativisht me te larte ne marketingun e produkteve** Agroproduktet e ketyre vendeve kane nje pamje komerciale te dukshme, jane te paketuara dhe etiketuara shume me mire ne krahasim me produktet e vendase.

Ekzistenca e nje industrie agroperpunuese konkuruese eshte elidhur me arritjen e avantazheve konkuruese nepermjet: brenda sektorit agroperpunimit

1. Promovimit te **clusters (grupimeve)** brenda sektorit agroperpunimit

Clusters (grupimet)kane dhene rezultate pozitive vendet ku jane zbatuar.

Vendosja e marredhenieve midis firmave te perfshira ne zinxhirin e vleres se shtuar ka impakt pozitiv ne avantazhet konkuruese te vendit. Prezenca e furnitoreve lokale, teknologjia, institutet kerkimore dhe shkencore, si dhe prezenca efciente dhe mbeshtetese fizike, infrastruktura institucionale dhe legale, lehtesojne reduktimin e kostove operacionale te biznesit, dhe rrisin konkurueshmerine. Ka premisa pozitive qe klaster mund te krijohen si pershembull:

- **Grupimet e perpunimit te mishit jane:** furnizuesit te mishit, erezave dhe aksesoreve te tjere, paketimit, disa perpunues te mishit dhe te sallamit dhe nje institut kerkimor per kete sector. Ne qofte se do te behen investime ne ngritjen e fermave te medha per prodhimin e mishit ky zinxhir do te ishte I plote dhe koncepti I ketyre grupimeve mund te vihej ne jete me ane te nje procesi te mireorganizuar dhe te mbeshtetur nga institucionet perkatese te biznesit.
- **Grupimet e perpunuesve te frutave dhe perimeve: Prodhuesit vendas te frutave dhe perimeve jane akoma te dobet Pjesa me e madhe lendes se pare per kete sector importohet. Por ekzistojne disa produkte vendas sic eshte fasulja pllaqi qe konkurrojne (bile dhe eksportohen) produktet e importuara. Nje riorientim I fermere drejt produkteve vertet konkuruesve sic jane, luleshtrydhet, frutat e pyllit etj. Do te ishte nje mundesi per biznesin e perpunimit. Ekziston nje numer i vogel I kompanive te vogla per perpunimin e**

frutave dhe perimeve ne rajon, dhe ka nje imazh te mire per disa nga keto produkte rajonale. Nje numer organizatash nderkombetare jane presente ne rajon me projekte mbeshetese per kete sektor dh enje institute kerkimoreshte gjithashtu present ne rajon. Nje pike e dobet eshte niveli I ulet I produkteve konkurruese:

Per rritjen e konkurrences se produkteve jane te nevojshme aktivitetet e meposhtme:

Se pari- permiresimi I eficences operuese te aktiviteteve me qellim qe te kthejne ne nje avantazh ekonomine e shkallezuar te procesin e prodhimit. Duke patur nje kosto te ulet per njesi, ata do te perfitojne nga kostoja dhe cmimi I ulet I produkteve. Kjo do te sjelle rritjen e pjeses qe do te zere agrobiznesi vendas ne treg, perfshi ketu dhe pjesen qe zene firnat e huaja te permendura ne kete material, dhe net e njejtën kohe do te rrise mundesite e penetrimit ne keto tregje te huaja.

Sedyti – strategjite e zhvillimit te produkteve, duke I ndare sipas llojeve. Kjo kerkon perpjekje per shtimin e llojeve te produkteve te disponueshme nje kategori specifike per to. Gjendja ekzistuese e prodhimit te sektorit te agrobiznesit shqiptar nuk eshte e ndare dhe kjo reflektohet ne mungesen e disa asortimenteve ne nje kategori te vetme te produkteve. Keto deficite kompesohen me produkte te importuara. Shtimi I asortimenteve do te kufizonte hapësirën per produkte te importuarane tregun shqiptar.

Se treti – **Perhapja** e imazhit te mire te produkteve vendas ne syte e konsumatoreve shqiptare duke permiresuar prodhimin dhe proceset e marketingut. Kjo kerkon rritje standarteve te cilesise (higjenes), perdorimit te paketimit modern dhe terheqes si dhe etikateve informuese- marka rajonale, dhe vules se cilesise.

Se katerti- zbatimi I reklamimit bashkohor dhe te njohura si dhe materilae te tjera promovuese.

S findi mund te themi se me shume strategji per tregtim konkurrues; dhe inally, it can be stated that more competitive sale strategies; rinovim I metodave dhe teknikave te marketingut te cilat shpesh rritin eficences operuese; produktet dhe sherbimet e reja te cilat do te bejne qe te jen me te vleresuara nga konsumatori, do te permiresonin pozicionin e produkteve bujqesore vendas ne treg dhe do te lehtesonin permiresimim e balancave tregtare mje vendet e rajonit dhe ato te Bashkimit europian, gje qe do te sillte reduktimin e deficitit te tregtise se Shqiperise.

2. Thithja e investimeve te huaja ne sektorin e perpunimit ushqimor.

Investimet e huaja jane ne gjendje te japin eksperiencia , kapitale, tregje te sigurta, teknologji bashkekohore, standarte te cilesise te prodhimit. Publiku i specializuar dhe instituconet private duhet te perfshihen ne menyre profesionale duke promovuar mundesite e biznesit dhe avantzhet e krahasuar te rajonit. Duhet te krijohet nje sinergji midis gjithe aktoreve per te patur nje situatë motivuese dhe te favorshme per investimet e huaja ne rajon.

III. Perfundime

Menyrat e implementimit per vizionin e zhvillimit te biznesit

Aktoret e zhvillimit të biznesit të rajonal si komunitetetë biznesit, institucionet e lidhura me biznesin, organizatat nderkombetare mbeshtetese të biznesit, autoritetet lokale duhet të pranojnë një vizion biznesi të perbashket dhe të krijojnë sinergji për implemmentimin e suksesshem të tij. Zhvillimi I ndermarrjeve të mesme dhe te vogla duke u fokusuar ne:

- Zgjerimi I sherbimeve të biznesit
- Mbeshtjtjen për krijimin e SME-ve dhe zhvillimin e tyre të qendrueshem ,
- Identifikimin e metodave për zhvillimin e grupimeve
- Projekte kerkimore/aktivitete për SME
- Transferimi I Teknologjive
- Zhvillimi I Parkut Industrial
- Asistence e vazhdueshme për SME-te
- Një rrjet informacioni të vazhdueshem dhe të qendrueshem për biznesin.

Zhvillimi I nje infrastrukture fizike të nevojshme

Zhvillimi I turizmit

- Investime në infrastrukturen e turizmit
- Promovim I sherbimeve të turizmit
- Marketingu rajonal
- Permirësimi I infrastruktures së trafikut në zonat malore

Zhvillimi I Burimeve Njerezore

- Universiteti I Korces ka një rol kyc në permirësimin e programit të tij sipas vizionit të zhvillimit të biznesit dhe kerkesave të tregut (të punës).

Thithja e investimeve të huaja të drejtperdrejta

- Organizimi dhe implemntimi I një marketingu rajonal sistematik për berjen të njohur të rajonit dhe Terheqjen e investitoreve

Komuniteti I biznesit duhet të informohet rregullisht në lidhje me Vizionin e Biznesit dhe sfidat e reja të tregut. Ato duhet të kenë në konsideratë zhvillimin ekonomik dhe dokumentat e zhvillimit rajonal (nqsë janë pergatitur dhe publikuar) dhe duhet të fokusojnë perpjekjet e tyre në rritjen e produkteve konkurruese nepermjet:

- Rinovimin e vazhdueshem të burimeve njerezore, kapitaleve dhe burimeve materiale;
- Ndryshimin në teknologji dhe stimulimin e novacionit;
- Njohjen dhe mbajtjen e standarteve të cilesise;
- Modifikimin e struktures organizative dhe veprimit;
- Krijimin/ inkurajimin e rrjeteve – intra sektoriale, inter- sektoriale dhe marredheniet nderkombetare.

Integrimi me Bashkimin European që tashme zyrtarisht ka filluar, është një aspiratë e madhe për shqipetaret. Shpejtesija e këtij procesi varet shumë nga ne. Nderkohe që ambicja e perbashket e shqipetareve është që të behen anetare të familjes së kombeve të avancuara Perendimore, koha është një faktor kritik për komunitetin e biznesit. Pjesmarrja në tregun e lire european sjell presion më të madh në sipermarresit për të

rinovuar bizneset e tyre duke adoptuar standartet analoge te rivaleve te tyre perendimore, ose perndryshe sjell falimentim. Si rezultat permiresimet konkuruese per ekonomine e pergjitheshme dhe bizneset duhet te jene nje celes prioritar per politikat shteterore, komunitetin e biznesit dhe per gjithe aktoret e perfshire ne kete proces

VIZIONI I ZHVILLIMIT EKONOMIK PER BASHKINE E KORCES, NEPERMJET ZHVILLIMIT TE BIZNESIT

Korca, qender e rendesishme urbane dhe universitare, promotor i zhvillimit ekonomik lokal dhe eurorajonal, ku Bashkia do te jete aktori kryesor i promocionit dhe zhvillimit te biznesit, nepermjet politikave te taksave, reduktimit logjik te procedurave burokratike, instalimit te politikave transparente.

Ne 2010, Korca do te ofroje ambjent konkurues ne raport me qendrat e tjera urbane per biznesin, nepermjet zhvillimit te infrastruktures, bashkepunimit institucional me aktore te tjere lokale duke u mbeshtetur ne potencialet dhe traditat e saj me te mira.

ANALIZA SWOT E BASHKISE SE KORCES

Pas mbledhjes se te dhenave statistikore mbi situaten ekonomike, u be nje vezhgim i aktiviteteve te bizneseve te Korces nepermjet plotesimit te pyetesoreve nga 70 biznese te vogla e te mesme. Analiza SWOT e Bashkise se Korces jep nje panorame te situates se zhvillimit ekonomik, nga kendveshtrimi i zhvillimit te biznesit

FAKTORËT	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVE	<p>Pikëmbështetjet</p> <p>Shtirirja Gjeografike (kufi me dy shtete) Infrastruktura e mire ne rajon Burime te mjaftueshme njerezore Qytet Universitar Mirefunksionimi i Qeverisjes Vendore Sistem Bankar Burime Natyrore te mjaftueshme Larmi Biznesesh Kanalizimi i ujerave te bardha e te zeza Egzistenca e tradites dhe vlerave kulturore Emigracioni (te mesuarit e profesioneve) Besueshmeria tek donatoret</p>	<p>Mundësitë</p> <p>Zhvillimi i turizmit Kthimi i emigranteve (potencial njerezor) Zhvillimi i agrobiznesit (perpunues) Prezenca e donatoreve potenciale ne Korce. Bashkepunime cross-border Te ardhurat per fryme te larta Bashkepunim i Pushtetit Lokal, Biznesit dhe Komunitetit Promovimi i traditave Zhvillimi i turizmit familjar</p>
NEGATIVE	<p>Dobësitë</p> <p>Largimi i specialisteve nga qyteti Emigracioni Fragmentarizimi i tokes Interes bankar i larte Mungese e iniciatives per te nisur nje biznes te ri Informalitet i larte ne biznes Mungese e nje marketingu profesional Infrastruktura e demtuar rrugore brenda rrethit Indiferenca e komunitetit per tu perfshire ne vendimmarrje</p>	<p>Rreziqet</p> <p>Konkurenca e pandershme Mosbashkepunim midis forcave politike Ndikim i politikës ne biznes Hapja e tregjeve rajonale Ndryshim i shpeshte i legjislacionit Ritmi i ulet i rritjes se popullsisë Mungesa e saktësisë se informacionit Terheqja e investitoreve nga fqinjët</p>

	Mungesa e bizneseve te medha Egzistenca e monopoleve Mungesa e politikave stimuluese per biznesin Mungesa e planeve urbanistike Mungesa e informacionit	
--	---	--


Ne lidhje me analizen, zhvillimi pozitiv ekonomik reflektohet ne pikat e forta si: shtrirja gjeografike, Qytet universitar, egzistenca e kanalizimeve te ujerave te zeza dhe te bardha, promovimi i traditave , bindja e qytetareve ndaj ligjit. Nga ana tjetere, mundesite jane ne nje lidhje te vazhdueshme me zhvillimin e biznesit : infrastruktura e mire ne rajon, jashte bashkise, potencial per zhvillimin e agrobiznesit (perpunues),prezenca e donatoreve potenciale ne Korce,bashkepunimet cross-border,bashkepunim i Pushtetit Lokal dhe biznesit, etj.

Nepermjet implementimit dhe zhvillimit te mundesive te qytetit te Korces, do te zvogelohen ose eliminohen pjesa me e madhe e dobesive dhe kerkenimeve ne menyre qe Bashkia e Korces te behet sa me atraktive per investitoret.

ZHVILLIMI I STRATEGJISE NE BASHKINE E KORCES

Nepermjet punes se kater grupeve per krijimin e nje analize SWOT, ne perputhje me fushen te ciles i perkisnin, u krijua nje analize e perbashket SWOT e situates ne Bashkine e Korces. Bazuar ne zhvillimet e deritanishme, egzistojne nje sere dobesish, te cilat pengojne zhvillimin e shpejte ne qytetin e Korces, por krahas tyre u identifikuan dhe shume avantazhe, te cilat mund te perdoren ne te ardhmen, duke dhene mundesi te medha rritjes dhe zhvillimit te hpejte te biznesit. Strategjia e zhvillimit ekonomik eshte pare ngushte me zhvillimin e biznesit, sepse ky i fundit perben nje nga segmentet me te fuqishme te zhvillimit ekonomik. Pergatitja dhe implementimi i kesaj strategjie, eshte nje proces me pese hapa, ne te cilat Bashkia e Korces ka qene dhe vazhdon te jete e perfshire:

Pergatitja dhe implementimi i Strategjise se Zhvillimit Vendor Nje proces me pese hapa



HAPI 5. Analiza e implementimit te Strategjise & masa plotesuese

Vizioni i Bashkise se Korces pasqyron te gjitha mundesite per zhvillim, duke dhene nje perskrim te se ardhmes ekonomike me avantazhet qe e perfaqesojne. Vizioni jep nje drejtim te qarte te zhvillimit te qytetit deri ne vitin 2010, e ne vazhdim.

Ky material jep rezultatet e fazes se trete te procesit te planifikimit te zhvillimit ekonomik, nepermjet te cilit komuniteti i qytetit te Korces, percakton dhe pranon vizionin e zhvillimit te Bashkise se Korces.

Skema dhe elementet kryesore te Strategjise se Zhvillimit Ekonomik:



Bashkia dhe te gjithë aktoret e perfshire ne kete proces mendojne te permbushin vizionin e percaktuar, nepermjet implementimit te synimeve te meposhtme:


- **Sigurimi i qendrueshmërisë dhe rritjes së bizneseve lokale duke koordinuar dhe mbështetur terheqjen e bizneseve të reja nepermjet politikave stimuluese.**
- **Zhvillimi i qendrushem urban, duke harmonizuar vlerat e urbanistikës së tradites me ato bashkekohore**
- **Korca, qendër universitare për të gjithë Shqipërinë Jugore, faktor i rëndësishëm në rritjen dhe përmirësimin e nivelit arsimor dhe profesional në të gjitha nivelet.**
- **Ruajtja, dhe zhvillimi i traditës kulturore, artistike dhe historike të Korces në funksion të zhvillimit të turizmit rajonal.**
- **Mjedisi**

Nepermjet krijimit te partneritetit midis Pushtetit Lokal dhe Komunitetit te Biznesit, krijimit apo përmirësimit te infrastruktures, zhvillimit te burimeve njerezore, Bashkia e Korces, synon te zhvilloje nje ambient te pershtatshem per krijimin e bizneseve te reja dhe zhvillimin e atyre egzistuese. Kjo gje do te coje ne hapjen e vendeve te reja te punes, rritjen e podhimit, rritjen e ekonomise dhe përmirësimin e cilesise se jetes se qytetareve.

Synimet e Strategjise se Zhvillimit Ekonomik nepermjet zhvillimit te biznesit ne Korce

Korca eshte nje nga qytetet me te rendesishme te Shqiperise, per vete shtrirjen e saj gjeografike (afër me kufirin e dy shteteve fqinje), dhe traditen, kulturen etj. Strategjia e Zhvillimit, eshte ambicioze duke pare zhvillimin e qytetit te fokusuar ne krijimin e qytetit ne:

- *qender e rendesishme urbane dhe universitare*
- *promotor i zhvillimit ekonomik lokal dhe eurorajonal*
- *ambjent konkurues ne raport me qendrat e tjera urbane per biznesin*



SYNIMI 5

Mjedisi
Krijimi i nje mjedisi te pershtatshem
per nje zhvillim te qendrueshem te
Bashkise

SYNIMI NR.1
Biznesi dhe Punesimi

Sigurimi i qendrueshmerise dhe rritjes se bizneseve lokale duke koordinuar dhe mbeshetur terheqjen e bizneseve te reja nepermjet politikave stimuluese.

Rritja e kapaciteteve teknike lokale ne sherbim te biznesit dhe shtimi i vendeve te punes ne masen 20% deri ne vitin 2010

Ofrimi I sherbimeve cilesore kerkon dhe nje pergatitje nga ana e punonjesve te Bashkise. Trajnimet, informatizimi I punes, e te tjera, do te aftesojne ata per tu pergjigjur ne kohe dhe me rezultat, kerkesave dhe problemeve te ndryshme te biznesit. Kjo do te conte ne nje ulje te rasteve te reagimeve burokratike.

Krijimi I nje ambienti te favorshem shvillimit te biznesit dhe I nje klime bashkepunimi te Pushtetit Lokal dhe Sektorit Privat, do te conte ne menyre te padiskutueshme ne hapjen e bizneseve te reja, ne forcimin e atyre egzistuese dhe si rezultat dhe ne hapjen e vendeve te reja te punes, duke zbutur ndjeshem nivelin e papunesise

PROGRAME PER TE ARRITUR OBJEKTIVIN

1. Krijimi i kushteve per zhvillimin e biznesit te vogel dhe te mesem.
2. Permiresimi i sherbimeve te Bashkise ndaj biznesit.
3. Zhvillimi i partneriteteve Bashki- biznes-komunitet.
4. Programe trajnimi per te rritur qendrueshmerine e bizneseve.

PROJEKTET QE DO TE IMPLEMENTOHEN

1. Ngritja e nje qendre te panaireve vendore dhe rajonale.
2. Ngritja e nje qendre te Partneriteteve Publiko-Private (PPP), si qender studimore dhe koordinuese ne funksion te zhvillimit ekonomik vendor.
3. Krijimi i nje Zyre me nje Ndalese per te lehtesuar procedurat per biznesin.
4. Hartimi dhe miratimi i rregullores per vendosjen e reklamave dhe tabelave per bizneset dhe i asaj per fasadat ne zonat tregetare.
5. Realizimi i investimeve te perbashketa bashki-biznes-komunitet per permiresimin e infrastruktures publike ne blloqe banimi dhe qendra argetimi.

SYNIMI NR.2
Urbanistika

Zhvillimi i qendrueshem urban, duke harmonizuar vlerat e urbanistikes se tradites me ato bashkekohore.



Objektivi 1.

Urbanizimi i qytetit ne perputhje me kriteret ligjore dha ato bashkekohore.

Rritja demografike e popullsisë, shtrirja e qytetit, kerkon nje studim te ri urbanistik, sipas standarteve te kohes. Por ne te njejten kohe, Korca eshte nje qytet me karakteristika te vecanta urbanistike, atraktive per te gjithë. Hartimi i studimit te ri urbanistik duhet te jete nje gershetim i te rese me traditen. Eshte nje domosdoshmeri, qe Bashkia te kete hartat dixhitale te rrjeteve inxhinierike per te gjitha institucionet. Per mbledhjen apo pergatitjen e tyre, eshte i nevojshem bashkepunimi institucional nepermjet projekteve te perbashketa egzistuese apo te se ardhmes.

Objektivi 2.

Ngritja ne nivele bashkekohore e cilesise se infrastructures dhe sherbimeve publike ne partneritet me komunitetin

Permiresimi I infrastructures eshte nje nga problemet e qytetit, qe ka influence te rendesishme ne zhvillimin e bizneseve te qytetit. Nevojiten nje numer I madh projektesh per zhvillimn kryesisht per rikonstruksion te rrugeve dhe ndertimin e rrugeve te reja, vendosjen e ndricuesave net e gjithë hapesirat publike te qytetit, si dhe rehabilitimin e rrugeve me kalldrem te zones karakteristike te qytetit.


PROGRAME PER TE ARRITUR OBJEKTIVIN

1. Hartimi i kornizes rregullatore per zhvillimin e territorit te Bashkise
2. Ndertimet dhe rehabilitimet urbane te koordinuara nga bashkia dhe institucionet lokale.
3. Modernizimi i bashkise dhe zyres se gjendjes civile.
4. Permiresimi dhe modernizimi i shkembimit te informacionit ndermjet bashkise dhe institucioneve lokale.
5. Permiresimi i rrugeve urbane dhe sherbimeve publike ne bashkepunim me komunitetin.



PROJEKTET QE DO TE IMPLEMENTOHEN

1. Hartimi i Planit te Pergjithshem Rregullues te qytetit.
2. Zhvillimi i zones tek varrezat te francezeve si zone rezidenciale.
3. Zbatimi i planit pjesor urban nga unaza e qytetit tek ish depoja, deri tek autostrada.
4. Ndertimi i linjave te kanalizimeve te ujrave te zeza.
5. Rehabilitimi i rrjetit shperndares te energjise duke perfshire edhe zonen industriale.
6. Hapja per zhvillim urban e zones nga hyrja e rruges se Ersekës deri tek Poliambulanca.
7. Informatizimi i te dhenave dhe i proceseve te punes ne zyrat e Bashkise.
8. Informatizimi i Zyres se Gjendjes Civile.
9. Krijimi i nje arkive kompiuterike per mbajtjen e adresave te qytetit



SYNIMI NR.4
Historia dhe Kultura

Ruajtja, dhe zhvillimi i traditës kulturore, artistike dhe historike të Korces në funksion të zhvillimit të turizmit rajonal.

Objektivi 1.

Promovimi intensiv dhe profesional i potencialeve turistike te Korces

Duke pasur parasysh se qyteti I Korces ka vlera te rendesishme turistike, Bashkia do te mundesoje reklamimin, zhvillimin e turizmit, ne bashkepunim me bizneset e kesaj fushe.

Objektivi 2.

Shtimi i ambjenteve qe promovojne historine dhe kulturen e Korces.

Nje nga menytrat e reklamimit te vlerave te qytetit, kapaciteteve te saj konkuruese, eshte edhe bashkepunimi rajonal dhe eurorajonal, jo vetem nepermjet projekteve, por edhe nepermjet aktiviteteve kulturore dhe artistike te perbashketa

PROGRAME PER TE ARRITUR OBJEKTIVIN

1. Ngritja e sistemeve per promovimin e potencialeve turistike te Korces.
2. Promovimi cilesor i historise dhe kultures nepermjet institucioneve publike.

PROJEKTET QE DO TE IMPLEMENTOHEN

1. Krijimi i qendres rajonale te informacionit mbi turizmin.
2. Krijimi i kalendareve vjetore te aktiviteteve kulturore dhe sportive
3. Rikonstruksioni i Teatrit "A.Z.Cajupi"
4. Ndertimi i Muzeut Historik te qytetit
5. Dikonstruksioni i Pazarit te Vieter

SYNIMI NR.5
Mjedisi

Krijimi i nje mjedisi te pershtatshem per nje zhvillim te qendrueshem te Bashkise.

Objektivi 1.

Ulja e nivelit te ndotjes ne standarte optimale

Prej disa vjetesh ne territorin ne afersi te burimeve te ujit te pijshem te Turanit ku furnizohet qyteti i Korces, zhvillohet tregtimi i bagetive te gjalla per rrethin Korce duke shkaktuar ndotje te tokes dhe rrezik per ndotje ne prespektive te ujerave nentokesore.

Objektivi 2.

Shtimi i siperfaqeve te gjelbra ne qytet.

Korca ka nje siperfaqe prej 224995m² e perfaqesuar kjo nga parqe, lulishte, breza te gjelber pergjate rrugeve dhe drure decorative ne ruge dhe shetitore. Nje fenomen qe vihet re kohet e fundit eshte demtimi I bimesise decorative dhe siperfaqes se barit ne parqe dhe lulishte.

Objektivi 3.

Ulja e nivelit te ndotjes se ajrit ne qytet.

Studimi i cilesise se ajrit te qytetit te Korces realizuar nga Drejtoria e Kujdesit Shendetesor Paresor korce ne bashkepunim me Inst. Shendetit Publik Tirane tregojne shifra me te larta se rekomandimet e OBSH per lendet e grimcuara ne suspension LGS dhe PM10.

PROGRAME PER TE ARRITUR OBJEKTIVIN

1. Trajtimi i mbetjeve urbane sipas parametrave ligjore.
2. Permiresimi i nivelit te gjelberimit te rrugeve dhe shesheve publike.
3. Prezantimi i nje sistemi per monitorimin e cilesise se ajrit te qytetit.

PROJEKTET QE DO TE IMPLEMENTOHEN

1. Rehabilitimi i fushes ekzistuese te mbledhjes se mbeturinave
2. Permiresimi i teknikave te menaxhimit te mbetjeve urbane
3. Studimi i cilesise se ajrit te qytetit te Korces Korces realizuar nepermjet monitorimit te tij gjate gjithë vitit nga Drejtoria e Kujdesit Shendetesor Paresor korce ne bashkepunim me Inst. Shendetit Publik Tirane

<p>Korca, qender e rendesishme urbane dhe universitare, promotor i zhvillimit ekonomik lokal dhe eurorajonal, ku Bashkia do te jete aktori kryesor i promocionit dhe zhvillimit te biznesit, nepermjet politikave te taksave, reduktimit logjik te procedurave burokratike, instalimit te politikave transparente. Ne 2010, Korca do te ofroje ambjent konkurues ne raport me qendrat e tjera urbane per biznesin, nepermjet zhvillimit te infrastruktures, bashkepunimit institucional me aktore te tjere lokale duke u mbeshtetur ne potencialet dhe traditat e saj me te mira.</p>	<p>S1. <u>Biznesi dhe Punesimi</u> Sigurimi i qendrushmerise dhe rritjes se bizneseve lokale duke koordinuar dhe mbeshtetur terheqjen e bizneseve te reja nepermjet politikave stimuluese.</p>	<p>S1.01. Rritja e kapaciteteve teknike lokale ne sherbim te biznesit.</p>	<p>S1.01.P1. Krijimi i kushteve per zhvillimin e biznesit te vogel dhe te mesem</p>	<p>S1.01.P1.p1. Ngritja e nje qendre PPP, studimore koordinuese ne funksion te zhvill.ekon vendor</p>
			<p>S1.01.P2 Permiresimi i ofrimit te sherbimeve te Bashkise ndaj biznesit</p>	<p>S1.01.P2.p1 Krijimi i nje zyre One Stop Shop ne Bashki (rrjet + zyra,)</p>
				<p>S1.01.P2.p2 Informatizimi i Bashkise</p>
				<p>S1.01.P2.p3 Krijimi i sistemit te adresave per qytetin</p>
<p>S1.01.P2.p4 Informatizimi i zyres se gjendjes civile</p>				
			<p>S1.01.P4 Aktivitete marketingu per promovimin e avantazheve konkuruese</p>	<p>S102.P4.p1 Ngritja e nje qendre te panairove lokale dhe rajonale (objekt, kosto operative, mobilim, publicitet, rogat, shpenzime,)</p>

		<p>S1.02. Ulja e nivelit te papunesise ne masen 20%.</p>	<p>S1.02.P5 Ngritja e tregjeve te lira te artizanatit</p>	<p>S1.02.P5.p1 Investime te perbashketa bashki+biznes+komunitet (joint venture per bllok banimi ose qender argetimi)</p>
		<p>S1.03. Permiresimi i cilesise se jeteses ne zonat me te varfera te qytetit.</p>	<p>S1.03.P6 Permiresimi i infrastruktures ne zonat e banuara nga minoriteti rom</p>	<p>S1.02.P6.p1 Rregullimi i infrastruktures rrugore dhe i sherbimit me uje te pijshem ne zonen e re</p>
	<p>S2. Urbanistika Zhvillimi i qendrueshem urban, duke harmonizuar vlerat e urbanistikes se tradites me ato bashkekohore.</p>	<p>S2.01. Hartimi i Planit te Ri Urbanistik i cili respekton traditat me te mira, dhe ne funksion te koncepteve te reja ekonomike</p>	<p>S2.01.P1. Hartimi i Planit te Ri urbanistik</p>	<p>S2.01.P1.p1. Hartimi i termave te references dhe studimeve paraprake per te hartuar planin urban.</p>
				<p>S2.01.P1.p2. Zhvillimi i zones moderne (zona e v.te francezeve), ekziston studim urbanistik</p>
				<p>S2.01.P1.p3. Krijimi i kushteve te ekzekutimit te studimit pjesor urban tek zona (ish deboja nga unaza e qytetit deri tek autostrada)</p>
			<p>S2.01.P2. Identifikimi dhe krijimi i poligonit te ri industrial, mbeshtetur ne nevojen dhe kerkesen e biznesit.</p>	<p>S2.01.P2.p1 Hapja e zones nga hyrja e rruges se Ersekës dhe deri tek Poliambulanca.</p>

				<p>S2.O1.P3.p2. Krijimi dhe miratimi i regullores se vendosjes se reklamave dhe tabelave ne zonat tregtare si dhe regulloret per fasadat ne keto zona.</p>	
				<p>S2.O1.P3.p3 Debat publik per percaktimin e zones historike dhe qendres se qytetit</p>	
			<p>S2.O2 Koordinimi i projekteve te perbashketa me institucione te rrjeteve inxhinierike me Bashkine.</p>	<p>S2.O2.P1. Konvertimi i te dhenave te institucioneve ne standartet e GIS.</p>	<p>S2.O2.P1.p1. Krijimi i hartave dixhitale te rrjeteve inxhinierike per cdo institucion.(per gjendjen egzistuese dhe projekte te zhvillimit)</p>
					<p>S2.O2.P1.p2 Ndertimi i linjave te reja te kanalizimit te ujerave te zeza.</p>
					<p>S2.O2.P1.p3 Rehabilitimi i rrjetit shperndares te energjise duke perfshire edhe zonen industriale (Zemblak-Nenstacion-kabine)</p>
					<p>S2.O3.P1.p2 Permiresimi i zonave te gjelbera ekzistuese dhe krijimi i zonave te reja te gjelbera</p>
		<p>S2.O3. Permiresimi i cilesise se jetes se qytetareve, nepermjet projekteve te perbashketa</p>	<p>S2.O3.P1. Permiresimi i siperfaqeve te gjelbera dhe rrugeve urbane nepermjer bashkepunimit me komunitetin</p>	<p>S2.O3.P1.p3</p>	

				Rikonstruksioni i rrugeve ekzistuese
				S2.O3.P1.p4 Kompletimi me ndricues i te gjitha hapësirave publike ne qytet
				S2.O3.P1.p5 Rehabilitimi i siperfaqes me kalldrem ne pjesen e vjeter te qytetit.
	S3: <u>Edukimi dhe njerëzit</u> Universiteti i Korces, faktor i rëndësishëm në rritjen dhe përmirësimin e nivelit arsimor dhe profesional në të gjitha nivelet.	S3.O1. Të zhvillohet pozicioni i Korces si qendër Universitare.	S3.O1.P1 Përmirësimi i infrastruktures se ambienteve te strehimit , mesimdhënies dhe shërbimeve per nxenesit e studentet.	S3.O1.P1.p1. Krijimi i ambienteve te reja ne funksion te Universitetit
		S3.O2. Rritja e kuadrit te kualifikuar ne te gjitha institucionet private dhe shteterore.	S3.O2.P1 Të përmirësojë në të gjithë nivelet e tjera arsimin dhe trajnimin profesional.	S3. O2.P1.pl. Rehabilitimi fizik i te gjitha shkollave te arsimit parauniversitar ne qytet.
		S3.O3 Krijimi i rrjeteve te ndryshme qytetare	S3.O3.P1 Mundësimi i qarkullimit dhe ofrimit te informacionit te gjithe te interesuarve.	S3.O3.P1.p1 Ngritja e nje Qendre te trajnimit/formimit profesional
				S3.O4.P1.p2. Krijimi i rrjetit te specialisteve te profesioneve te ndryshme

	S4. <u>Historia dhe Kultura</u> Zhvillimi i traditës Artistike, kulturore dhe historike të Korces kusht per nje zhvillim te qendrueshem Rajonal	S4.01 Ngritja e kapaciteteve te infrastruktures perkatese ne funksion zhvillimit te turizmit dhe te rritjes se cilesise se jeteses.	S4.01.P1. Venia ne eficience e ambiente ekzistuese nga bashkia, ne bashkepunim me biznesin dhe NGO, etj.	S4.01.P1.p1 Krijimi i nje kompleksi sportiv modern midis shkollave “Demokracia” dhe “Naum Veqilharxhi”
				S4.01.P1.p2 Krijimi i qendres rajonale te informacionit mbi turizmin.
		S4.02 Krijimi i aktiviteteve te perbashketa kulturore dhe sportive, ne kuader te eurorajonit.	S4.02.P1. Promovimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive në funksion të zhvillimit të turizmit rajonal dhe eororajonal.	S4.02.P1.p1 Krijimi i kalendareve vjetore te aktiviteteve kulturore dhe sportive
				S4.01.P1.p2 Permiresimi i ambienteve te Teatrit „A.Z.Cajupi”, si dhe te elementeve te tjere, ndricim, foni, etj
				S4.01.P1.p3 Ndertimi i Muzeut Historik te qytetit
				S4.01.P1.p4 Rikonstruksioni i Pazarit te Vjeter

	S5. <u>Mjedisi</u> Krijimi i nje mjedisi te pershtatshem per nje	S5.01 Ulja e nivelit te ndotjes ne standarte optimale	S5.01.P1. Ruajtja dhe permiresimi I mjedisit	S5.01.P1.p1 Rehabilitimi i fushes ekzistuese te mbledhjes se mbeturinave urbane
--	--	---	--	---

	zhvillim te qendrueshem te Bashkise			S5.O1.P1.p2 Permiresimi i teknikave te menaxhimit te mbetjeve urbane (Ndertimi i fushes se re te mbledhjes dhe perpunimit te mbeturinave urbane)
		S5.O2 Permiresimi I habitatit dhe biodiversitetit ne kodrat e qytetit.	S5.O2.P2 Rehabilitimi i zonave te gjelbera ne kodrat e qytetit	
		S5.O3 Reduktimi i mundshem i te gjithë faktoreve qe ndikojne ne ndotjen e ajrit ne qytet	S5.O2.P3 Evidentimi i situates se ambientit, te shkaktuar nga pluhurat e rrugeve, kryesisht nga lendet e grimcuara ne suspension dhe PM10.	S5.O2.P3.p1 Studimi i cilesise se ajrit te qytetit te Korces Korces realizuar nepermjet monitorimit te tij gjate gjithë vitit nga Drejtoria e Kujdesit Shendetesor Paresor korce ne bashkepunim me Inst. Shendetit Publik Tirane

Nr. 1	Projekti: Q1:O1:PG1: p3: Ngritja e nje qendre te panaireve vendore dhe rajonale.	Programi: Q1:O1:PG1: Krijimi i kushteve, lehtësuarave dhe ambjenteve per zhvillimin e biznesit te vogel dhe te mesem.
Vlera XXX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Periudha e tranzicionit ka sjelle me vete vec efekteve pozitive, edhe efekte negative. Zvogelimi i numurit te popullsise eshte pjese e uljes se nivelit te jeteses si edhe e aktivitetit ekonomik. Aktiviteti privat, sot ka nevojte per nje imazh te ri, per nje permiresim te marketingut, duke i bere bizneset tona sa me konkruese ne rajon. Ky projekt ka per qellim ngritjen e nje qendre te panaireve lokale dhe rajonale. Ne kete menyre, do te organizohen panaire specifike te cilat do te reklamojne periodikisht prodhime, studime dhe teknologji ekzistuese dhe te reja.</p> <p>Kjo qender do te jete nje bashkepunim i gjithe biznesit, duke e kthyer ate ne nje menyre publiciteti e bizneseve te qytetit dhe te rajonit, duke e kthyer qytetin e Korces ne nje qender te panaireve rajonale. Tregues i suksesit do te ishte krijimi i nje tradite, nepermjet ketyre panaireve. (psh. ne nje muaj te caktuar do te jete panairi i mobiljeve, etj)</p>		
Rezultatet e pritshme:	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Krijimi i nje tradite te organizimit te panaireve periodike ⇒ Krijimi i nje marketingu profesional ⇒ Kthimi i Korces ne qender rajonale te biznesit 	Grupet e synuara:
		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Bizneset e qytetit dhe prefektures ⇒ Bizneset e tjera te Shqiperise ⇒ Bizneset e rajonit
Pjesemarrjesit kryesore:	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pushteti Vendor dhe DHTI ⇒ Bizneset e rajonit ⇒ Pronaret e tokes ⇒ Donatoret 	Kontributet kryesore ne projekt:
		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mirekuptim dhe mbeshtetje financiare ⇒ Mbeshtetje, per dhenien e tokes kundrejt nje pagese ⇒ Mbeshtetje financiare
Parakushtet:	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor dhe komunitetit te biznesit per te mbeshtetur kete ide ; ⇒ Dëshira e donatoreve dhe biznesit per te dhene mbeshtetje financiare dhe asistence Bashkise dhe DHTI; ⇒ Projekt cilesor 	Faktoret e rrezikut:
		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Buxhet i kufizuar; ⇒ Mungesa e donatoreve potenciale ⇒ Gjetja e vendit ku do te ngrihet qendra
Shpenzimet e parashikuara:		
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ 120,000 Euro (perfshin ndertim objekti, kosto operative, mobilim, publicitet, rroga, shpenzime etj) 		
Periudha e zbatimit:	⇒ Nje vit 2005-2010	Periudha e ndikimit:
		⇒ Pas vitit 2005.

Nr. 2	Projekti: Q1:O1:PG1:p4: Ngritja e një qendre të Partneriteti Publiko Privat (PPP), si qëndër studimore dhe koordinuese në funksion të zhvillimit ekonomik vendor.	Programi: Q1:O1:PG1: Krijimi i kushteve, lehtësuarave dhe ambjenteve për zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm.
Vlera XX		
<u>Pershkrim i shkurtër i projektit:</u>		
<p>Stafi i Bashkise në përgatitjen e projekteve të ndryshme për zhvillimin ekonomik vendor, bashkepunon me përfaqësues të grupeve të ndryshme të komunitetit. Procesi i aplikimit dhe i monitorimit të tyre është po aq i rëndësishëm sa edhe ai i përcaktimit të problemit dhe i hartimit të projektit. Shumë prej projekt-ideve janë të gjera dhe përfshijnë interesa të ndryshme të komunitetit, institucioneve, organizatave, biznesit etj.</p> <p>Bashkepunimet midis Bashkise, biznesit dhe institucioneve të tjera, mendojmë se do të ishin me sukses. Kjo qendër do të identifikojë problemet e ndryshme, koordinimin e punës së të gjithë aktoreve për të përcaktuar projekt-idetë dhe më pas do të hartojë projekt-propozimet për të aplikuar më pas tek donatorët e mundshëm për sigurimin e fondeve të nevojshme duke monitoruar implementimin e projekteve. Do të bëhet një qendër edhe për studime të ndryshme të cilat u paraprijnë hartimit të strategjive, apo planeve të vecanta, projekteve konkrete etj. Ngritja e kësaj qendre do të ndihmojë gjithashtu në konkretizimin e një bashkepunimi të pushtetit lokal, biznesit dhe komunitetit në interes të të gjithëve.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Krijimi i partneritetit midis të interesuarve ⇒ Identifikimi i nevojave reale të zhvillimit ekonomik ⇒ Hartimi i projekt-propozimeve në një mënyrë sa më profesionale ⇒ Gjetja e fondeve të mundshme për implementimin e projekteve 	<p>Grupet e synuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Komuniteti ⇒ Biznesi ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Institucionet 	
<p>Pjesëmarrësit kryesorë</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Biznesi Vendor ⇒ Institucionet shtetërore ⇒ Donatore, ekspertë. 	<p>Kontribuesit potenciale të projektit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Miratimi nga Këshilli i Bashkise. ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Identifikimi i të interesuarve ⇒ Bashkepunimi i pushtetit lokal me bizneset lokale si dhe institucionet ⇒ Mbeshtetje financiare, ekspertize 	
<p>Parakushtet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor, biznesit dhe institucioneve për të mbështetur idetë 	<p>Faktoret e rizikut</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Buxheti i pamjaftueshëm ⇒ Mungesa e interesit nga ndonjë aktor për të bashkepunuar 	
<p>Shpenzimet e llogaritura: ⇒ 15,000 Euro</p>		
<p>Periudha e implementimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Viti 2005 	<p>Periudha e ndikimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Nga viti 2005 në vazhdim 	

Nr. 3	Projekti: Q1:O1:PG2:p1: Krijimi i një Zyre me Një Ndalesë për të lehtësuar procedurat për biznesin.	Programi: Q1:O1:PG2: Permiresimi i ofrimit të shërbimeve të Bashkisë ndaj biznesit.
Vlera XXX	<u>Pershkrim i shkurtër i projektit:</u> Realizimi i këtij projekti ka për qëllim të përmirësojë shërbimet e Bashkisë ndaj biznesit. Kjo zyre do të thjeshtonte mënyrën e zgjidhjes së kërkesave të tyre dhe në një kohë sa më të shkurtra. Të gjithë të interesuarve do t'u vihen në dispozicion formularet të cilët duhet të plotësohen, informacion lidhur me probleme të ndryshme, shërbimet që bashkia u ofron por edhe detyrimet e tyre ndaj saj, bazën ligjore të nevojshme, etj, lehtësi në plotësimin e dokumentacionit, etj. Suksesin e kësaj zyre ka të bëjë me ekzistencën e një informacioni sa më të kompletuar, i cili do të mund t'u shërbejë si bizneseve të reja të cilat do të mund të fillojnë një aktivitet, ashtu edhe atyre ekzistuese. Për realizimin e këtij projekti do të duhen të ndërmeren disa hapa të nevojshme: <ol style="list-style-type: none"> 1. Ngritja e zyrës One Stop Shop, pajisja me infrastrukturën e nevojshme (kompjutera, rrjet, fotokopje, printera, etj) përcaktimi i personelit, trajnimi i tij për të qenë i aftë t'u përgjigjet kërkesave të biznesit 2. Ndertimi i një pakete ligjore lokale për zhvillimin dhe nxitjen e biznesit. Kjo do të qartësojë marrëdhëniet, detyrimet e secilës pale për probleme specifike, duke i hapur rrugë bashkëpunimeve konkrete të Pushtetit Lokal dhe Biznesit 3. Identifikimi i paketave formative për biznesin (sipas standarteve vendase dhe të BE-së), për t'u ardhur në ndihmë të gjithë investitorëve vendas dhe të huaj me informacionin e nevojshëm, duke krijuar një klimë sa më të favorshme për të investuar. Ne këto mënyra të gjithë që do të duan të hapin një biznes të ri dhe ata që e kanë krijuar do të gjejnë pranë Bashkisë një zyrë, e cila funksionon vetëm për t'u ardhur në ndihmë atyre, me materiale, informacion, asistencë ligjore etj, si dhe shërbime sa më të shpejta. Implementimi i këtij projekti do të ecë në mënyra paralele me informatizimin e gjithë Drejtorive të Bashkisë.	
Rezultatet e pritshme: ⇒ Krijimi i Zyrës me Një Ndalesë me të gjitha materialet e nevojshme ⇒ Sigurimi i një klimë të favorshme për ofrimin e shërbimeve ndaj biznesit në një kohë sa më të shkurtra ⇒ Vendosija e një bashkëpunimi konkret, bashki-biznes		Grupet e synuara: ⇒ Biznesi i vogël dhe i mesëm ⇒ Bizneset e reja ⇒ Pushteti Vendor
Pjesëmarrësit kryesorë: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Donatore		Kontributet kryesore në projekt: ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike
Parakushtet: ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor dhe komunitetit të biznesit për të mbështetur këto ide ; ⇒ Projekt çilesor		Faktoret e rrezikut: ⇒ Buxheti i kufizuar; ⇒ Mungesa e personelit të kualifikuar
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 15,000 Euro		
Periudha e zbatimit: ⇒ Një vit 2005-2006		Periudha e ndikimit: ⇒ Pas vitit 2005.

Nr. 4	Projekti : Q2:O1:PG2:p3: Hartimi dhe miratimi i rregullores për vendosjen e reklamave dhe tabelave për bizneset dhe i asaj për fasadat në zonat tregëtare.	Programi: Q1:O1:PG2: Permiresimi i ofrimit te sherbimeve te Bashkise ndaj biznesit.
Vlera XX	<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>	
<p>Shume probleme dhe debate krijohen ndermjet punonjesve te Pushtetit Lokal dhe bizneseve, ne momentin e pageses se detyrimeve te tyre, per shkak te mungeses se nje rregulloreje se vendosjes se reklamave dhe tabelave ne zonat tregetare si dhe rregulloret per fasadat ne keto zona. Eshte nje domosdoshmeri qe te kete nje korrektesi dhe transparence mbi detyrimet qe kane bizneset, duke shprehur nepermjet kesaj rregulloreje, te gjitha informacionet mbi detajet e mundshme. Eshte llogjike qe cdo pike e shprehur atje, te jete ne perputhje me pretendimet e biznesit dhe e miratuar ne Keshillin Bashkiak. Ne kete menyre cdo gje do te funksionojë bazuar ne nje rregullore, te njohur per te gjithë dhe bizneset do te jene te ndergjegjshem per detyrimet e tyre ndaj Pushtetit Lokal.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme: ⇒ Funksionimi i mbledhjes se taksave te tabelave dhe reklamave, si dhe vendosja e tyre ne baze te nje rregulloreje ⇒ Ndergjegjesimi i bizneseve dhe i Pushtetit Lokal per te qene transparente ndaj njeri-tjetrit</p>	<p>Grupet e synuara: ⇒ Bizneset ⇒ Pushteti Vendor</p>	
<p>Pjesemarresit kryesore: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Bizneset ⇒ Keshilli Bashkiak</p>	<p>Kontributet kryesore ne projekt: ⇒ Mbeshtetje teknike dhe financiare ⇒ Mirekuptimi i biznesit ⇒ Miratim nga Keshilli Bashkiak</p>	
<p>Parakushtet: ⇒ Hartimi i rregullores ne perputhje me kerkesat e Biznesit ⇒ Miratimi ne Keshillin Bashkiak</p>	<p>Faktoret e rrezikut: ⇒ Mosmiratimi ne Keshillin Bashkiak ⇒ Nje rregullore qe nuk perputhet me pretendimet e biznesit</p>	
<p>Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 1.000 Euro</p>		
<p>Periudha e zbatimit: ⇒ 2005</p>	<p>Periudha e ndikimit: ⇒ Pas Janar 2005</p>	

Nr. 5	Projekti: G1:O1:PG3:p1: Realizimi i investimeve te perbashketa bashki+biznes+komunitet per permiresimin e infrastruktures publike ne blloqe banimi dhe qendra argetimi.	Programi: Q1:O1:PG3: Zhvillimi i partneriteteve Bashki biznes dhe komunitet.
Vlera XXX		
<p align="center"><u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u></p> <p>Momentet te cilat po kalon qyteti ne te gjitha fushat, jane te veshtira. Zhvillimi i tij dhe permiresimi i kushteve te jeteses se qytetareve, pengohet shpesh nga buxheti i kufizuar. Nje domosdoshmeri per zgjidhjen dhe implementimin e shume problemeve dhe projekteve, eshte bashkepunimi i Bashkise me biznesin dhe komunitetin. Eshte normale qe biznesi te kete me shume ide dhe eksperience per probleme te vecanta, qe per qytetin jane thelbesore. Per shume kohe, bashkepunimi me biznesin ka qene shume i vogel. Tani, Bashkia ka krijuar maredhenie shume te mira me biznesin, duke hartuar projekt ide te perbashketa, te cilat do te mund ti vene ne zbatim me sukses. Mungesa e ambienteve te ndryshme argetimi ne qytet, eshte nje nga problemet qe has shpesh komuniteti. Nje bashkepunim Bashki, biznes, komunitet, do te mundesoje krijimin e nje kompleksi modern per argetimin e te gjitha moshave. Ne kete projekt:</p> <p>Bashkia, do te marre pjese me vendin (ish pishina), projekt-zbatimin, Biznesi, do te pergatite planin e biznesit dhe financimin per nje pjese te projektit Komuniteti, i cili perfshin disa persona, te cilet kane deshire jo vetem te fitojne por edhe te kene ku te argetohen, do te kontribojne financiarisht.</p> <p>Pergatitja e nje projekti konkret, do te mund te percaktoje menyren e organizimit, te funksionimit, numurin e kontribuseve, etj. Kjo praktike mund te ndiqet ne funksion te ideve te ndryshme per nje bashkepunim bashki-biznes</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒ Krijimi i nje bashkepunimi konkret, bashki-biznes-komunitet ⇒ Permiresimi i cilesise se jetes se qytetareve ⇒ Zgjimi i interesit te komunitetit per te investuar.	Grupet e synuara: ⇒ Komuniteti ⇒ Biznesi ⇒ Pushteti Vendor	
Pjesemarresit kryesore: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Pushteti Qendror ⇒ Biznesi ⇒ Komuniteti	Kontributet kryesore ne projekt: ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mirekuptimi i biznesit, mbeshtetje financiare ⇒ Pune konkrete ne ndihme te punonjesve	
Parakushtet: ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor, biznesit dhe komunitetit per te mbeshtetur kete ide ; ⇒ Mundesia e shfrytezimit te pronave te saj nga ana e Bashkise ⇒ Angazhim serioz per nje projekt cilesor	Faktoret e rrezikut: ⇒ Vonesa ne regjistrimin e pronave te Bashkise ⇒ Buxhet i kufizuar; ⇒ Mungesa deshires se biznesit ose komunitetit per te qene partnere	
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 200.000 Euro		
Periudha e zbatimit: ⇒ 2005 - 2010	Periudha e ndikimit: ⇒ 2005 e ne vazhdim.	

Nr. 6	Projekti: Q1:O1:PG3:p2: Ndërtimi i një baze të dhënash për specialistët e profesioneve të ndryshme për të lehtësuar identifikimin e tyre nga punëmarrësit.	Programi: Q1:O1:PG3: Zhvillimi i partneriteteve Bashki biznes dhe komunitet.
Vlera XX	Pershkrim i shkurtër i projektit:	
<p>Shkembimi i informacionit, qendrojnë në themel të zhvillimit. Institucione dhe specialiste të ndryshëm, kanë informacione të ndryshme, të cilat shumë të interesuar nuk mund ti përdorin duke mos ditur se ku të gjejnë ato. Aktualisht, njëzërit i zgjidhin problemet nëpërmjet miqësive apo të njohurve, por jo gjithmone këto zgjidhje janë ato që ata kanë nevojë. Në shumë raste probleme të ndryshme kërkojnë ndërhyrje me profesionale, të cilat mund ti japin vetëm specialistet përkatës. Një zgjidhje për të lehtësuar gjetjen dhe përdorimin e informacionit, do të ishte dhe krijimi i rrjeteve të ndryshme të specialisteve. Në këtë mënyrë, krijimi i databesave për të gjithë specialistet sipas profesioneve me të dhëna të detajuara dhe krijimi i rrjeteve përkatëse, do të ndihmonte për identifikimin e specialisteve sipas profesioneve. Në këtë mënyrë, të interesuarve do t'u duhej vetëm një hyrje në rrjetin përkatës dhe të zgjedhin prej atyre personin e duhur. E njëjta gjë do të mund të aplikohet edhe për materiale, libra etj. (psh. rrjeti i bibliotekave qytetare, etj)</p>		
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Krijimi i një baze të dhënash dhe informacionesh të nevojshme për fusha të ndryshme ⇒ Mundësi të krijimit dhe përdorimit të rrjeteve të ndryshme ⇒ Ofrimi i të gjithë informacionit të nevojshëm për të interesuarit ⇒ Lehtësimi i zgjidhjes së problemeve të qytetarëve 	<p>Grupet e synuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Specialistët e fushave të ndryshme ⇒ Qytetarët 	
<p>Pjesëmarrësit kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Specialistët e interesuar për të hyrë në rrjet ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Pushteti Qendror ⇒ Donatorë 	<p>Kontributet kryesore në projekt:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbeshtetje teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike 	
<p>Parakushtet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Sigurimi i pjesëmarrjes së specialisteve në këtë proces ⇒ Terheqja e interesit të donatorëve për të financuar këtë projekt 	<p>Faktoret e rrezikut:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Buxheti i kufizuar 	
<p>Shpenzimet e parashikuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ 20,000 Euro 		
<p>Periudha e zbatimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ 2005 - 2007 	<p>Periudha e ndikimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pas 2005 	

Nr. 7	Projekti: Q1:O1:PG4:p1: Ngritja e një Qendre të Formimit Profesional.	Programi: Q1:O1:PG4: Krijimi i lehtësirave trainuese për bizneset. Ofrimi i programeve të trajnimit në funksion të rritjes dhe qendrueshmerise se bizneseve.
Vlera XXX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Kalimi në ekonomine e tregut, kërkon dhe ngritjen e kapaciteteve të punonjesve në të gjitha institucionet shtetërore dhe ato private dhe të gjithë të tjerëve për të qenë të aftë të konkurojnë në tregun e punës. Kërkesat për trajnim në fusha të ndryshme, janë të shumta. Bashkia nxit dhe stimulon vazhdimisht krijimin e këtyre mundësive, jo vetëm nepermjet mbështetjes institucionale, por edhe konkretisht, nepermjet venies në dispozicion të ambienteve (prona të saj). Ambientet e ishuzinave apo Ishfabrikave, të cilat aktualisht janë pa funksion dhe duke u prishur, kanë filluar të vihen në funksion të projekteve, iniciativave të ndryshme, qofshin ato private apo shtetërore. Në një nga këto ambiente, (uzina e ishprecizionit), do të ngrihet dhe një qender e trajnimit / formimit profesional, e financuar edhe nga Ministria e Punës. Eksperiencia të tilla kanë ekzistuar në qytetin e Korces dhe mund të vlerësohen si pozitive. Kërkesa të shumta ngrihen edhe nga biznesi për kualifikimin e punonjesve të tyre, njohjen e kompjuterit dhe të programeve të reja, gjuhëve të huaja, etj.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Ofrimi i trajnimeve nga profesioniste ⇒ Rritja e nivelit profesional të të interesuarve. ⇒ Terheqja e interesit të punonjesve të institucioneve shtetërore dhe atyre private për të rritur kërkesat për përgatitjen e tyre. ⇒ Permiroresimi i punës në instucione dhe biznese. 	<p>Grupet e synuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Studentet e Universitetit ⇒ Punonjesit e Institucioneve ⇒ Të punësuarit në Biznes 	
<p>Pjesëmarrësit kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pushtetit Vendor ⇒ Pushteti Qendror ⇒ Donatore 	<p>Kontributet kryesore në projekt:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike. Miratim nga Keshilli Bashkiak ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare 	
<p>Parakushtet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Miratim në Keshillin Bashkiak për qëllimin e funksionimit të pronave të Bashkise ⇒ Terheqja e interesit të Pushtetit Qendror dhe donatoreve për të financuar këtë projekt 	<p>Faktoret e rrezikut:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mosmiratim nga Keshilli Bashkiak për mbështetje të këtij projekti ⇒ Buxhet i kufizuar 	
<p>Shpenzimet e parashikuara:</p> <p style="text-align: center;">⇒ 70.000 Euro</p>		
<p>Periudha e zbatimit:</p> <p>⇒ 2005 - 2006</p>	<p>Periudha e ndikimit:</p> <p>⇒ Pas 2006</p>	

Nr. 8	Projekti: Q2:O1:PG1:p1: Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit i cili respekton traditën urbane dhe konceptet e reja ekonomike	Programi: Q2:O1:PG1: Hartimi i kornizës rregullatore për zhvillimin e territorit të Bashkisë.
Vlera XXX		
<p style="text-align: center;"><u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u></p> <p>Duke u nisur nga situata aktuale e zhvillimit dhe ndryshimeve demografike dhe ekonomike të qytetit është shumë i rëndësishëm hartimi i një studimi të ri urbanistik. Ky projekt synon të zgjidhë probleme të ndryshme si: permiresimi i infrastruktures lokale, zbutjen e varferise, permiresimin e mjedisit urban, zhvillimin ekonomik, permiresimin e kushteve të jeteses, mireqeverisjen. Ky projekt mund të realizohet edhe nepermjet studimeve pjesore për zona të ndryshme të qytetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i termave të references. - Studim urban i qendres së qytetit. - Studim urban i kodrave të qytetit - Studim urban i zones industriale të qytetit.etj <p>Zhvillimi demografik i qytetit, është një proces pozitiv, por sjell edhe aspekte të ndryshme negative në qoftë se nuk ekziston një plan urbanistik aktual, që të paraprijë zhvillimin urban. Pra, është e nevojshme një plan urbanistik, i cili të perputhet me kërkesat bashkekohore. Në duhet të parashikojmë dhe të përcaktojmë zhvillimin e qytetit në të ardhmen, kështu, do të jemi të aftë të menaxhojmë burimet tona.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Krijimi i mundësive për hartimin e planeve urbanistike ⇒ Përcaktimi i zones së ardhshme industriale ⇒ Permiresimi i ambjentit urban ⇒ Permiresimi i infrastruktures vendore 		<p>Grupet e synuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Komuniteti ⇒ Biznesi ⇒ Pushteti Vendor
<p>Pjesëmarrësit kryesorë</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Biznesi Vendor ⇒ Donatore, eksperte. 		<p>Kontribuesit potenciale të projektit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Miratimi i planit urbanistik si një prioritet nga Këshilli Bashkiak. Mbeshtetje financiare ⇒ Bashkepunimi i pushtetit lokal me bizneset lokale për të dhënë mbështetjen financiare. ⇒ Identifikimi i donatoreve
<p>Parakushtet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor dhe biznesit për të mbështetur idenë ⇒ Dëshira e donatoreve për të mbështetur me asistencë dhe financiarisht projektet tona 		<p>Faktoret e rizikut</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Buxheti i pamjaftueshëm ⇒ Mungesa e donatoreve potenciale
<p>Shpenzimet e llogaritura:</p> <p style="text-align: center;">⇒ 80,000 Euro</p>		
<p>Periudha e implementimit</p> <p>⇒ Tre vjet 2005-2008</p>		<p>Periudha e ndikimit</p> <p>⇒ Nga viti 2008</p>

Nr. 9	Projekti: Q2:O1:PG2:p1: Zhvillimi i zonës tek varrezat te francezeve si zonë rezidenciale.	Programi : Q2:O1:PG2: Ndertimet dhe rehabilitimet urbane te koordinuara nga bashkia dhe institucionet lokale.
Vlera XXX	<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>	
<p>Gjate viteve te fundit, jane bere nje sere studime urbanistike pjesore, per zonat e reja te banimit ne qytet. Edhe per zonen, e njohur Varret e Francezeve, ekziston nje studim urbanistik cilesor, i cili eshte prezantuar publikisht dhe i mirepritur si nga specialiste, ashtu edhe nga qytetare. Venia ne zbatim e ketij studimi ka hasur pengesa te ndryshme, ligjore dhe teknike. Sukseset e realizimit te ketij projekti, kerkon nje bashkepunim te ngushte me biznesin. Krijimi i ketij partneriteti, do te detajoje si ndarjen e kostove ashtu edhe te perfitimit. Qellimi kryesor dhe interesi i Bashkise per realizimin e ketij projekti eshte i shumeanshem. Bashkia synon jo vetem zhvillimin e kesaj zone si zone rezidenciale, me te gjitha infrastrukturen e nevojshme, por edhe venien ne dispozicion te te pastreheve, te apartamenteve qe do te perfitoje si rrjedhoje e marreveshjes me biznesin. Ne te njejten kohe, zbatimi i studimit ekzistues, do rrite numrin e popullsisë ne kete zone, duke stimuluar ngritjen e bizneseve te reja duke siguruar keshtu nje zhvillim te qendrueshem.</p>		
Rezultatet e pritshme:		Grupet e synuara:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Krijimi i bashkepunimit me biznesin e ndertimit ⇒ Krijimi i nje zone banimi moderne ⇒ Zgjidhja e problemit te nje pjese te te pastreheve ⇒ Hapja e bizneseve te reja 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Bizneset e ndertimit ⇒ Te pastrehet ⇒ Komuniteti i kesaj zone ⇒ Pushteti Vendor
Pjesemarresit kryesore:		Kontributet kryesore ne projekt:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Bizneset e ndertimit ⇒ Donatore ⇒ Qeveria Qendrore ⇒ Komuniteti 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Bashkepunime publik-privat ⇒ Mbeshtetje financiare ⇒ Mbeshtetje financiare ⇒ Ndergjegjesim, mirekuptim i komunitetit
Parakushtet:		Faktoret e rrezikut:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Perfundimi i procesit te privatizimit ⇒ Krijimi i nje bashkepunimi publik-privat ⇒ Miratimi i Keshillit Bashkiak 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mosbashkepunim midis Pushtetit Vendor dhe biznesit privat ⇒ Mosmiratim i Keshillit Bashkiak ⇒ Vonesa ne perfundimin e procesit te privatizimit ⇒ Mungesa e fondeve
Shpenzimet e parashikuara:		
⇒ 300.000 Euro		
Periudha e zbatimit:		Periudha e ndikimit:
⇒ 2005 - 2010		⇒ Pas 2005

Nr. 10	Projekti: Q2:O1:PG2:p2: Hapja për zhvillim urban e zonës nga hyrja e rrugës se Ersekës deri tek Poliambulanca.	Programi : Q2:O1:PG2: Ndertimet dhe rehabilitimet urbane te koordinuara nga bashkia dhe institucionet lokale.
Vlera XXX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Zhvillimi dhe shtrirja e qytetit, kerkojne jo vetem krijimin e rrugeve te reja, por edhe rehabilitimin apo zgjerimin e atyre ekzistuese. Shtimi i numrit te makinave, ndertimet e reja jashte qytetit, bejne qe te zgjerohet shume shfrytëzimi i rrugeve ekzistuese, te cilat nuk jane te pershtatshme as si vendosje, as si cilesi per te sherbyer si akse kryesore te qytetit. Per kete arsye, nje pike e rendesishme qe do te mundesonte zgjidhjen e ketyre problemeve dhe lehtesimin e levizjes se automjeteve, duke sherbyer si nje arterie kryesore eshte edhe hapja e zones nga hyrja e rruges se Ersekës, deri te poliambulanca. Realizimi i ketij projekti nuk eshte i thjeshte per faktin se permbledh jo vetem projektin e ndertimit te rruges, por edhe prishjen e disa shtepive banimi atje, gje e cila do te mundesoje edhe zgjerimin e rruges. Implementimi i ketij projekti, eshte i lidhur me procese te tjera, ate te shpronësimit dhe kompensimit te pronareve dhe me pas te ndertimit te rruges. Ky eshte nje nga projektet qe i paraprin zhvillimit dhe frymemarrjes se qytetit, sipas standarteve te kohes, duke bere te mundur edhe hapjen e bizneseve te reja qe do te mundesojne zhvillimin e kesaj zone te qytetit.</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒ Realizimi i shpronësimeve dhe kompensimeve, pa krijuar probleme sociale ⇒ Permiresimi i cilesise se jetes se qytetareve ⇒ Permiresimi i kesaj zone te qytetit duke u hapur rruge zhvillimit te bizneseve te reja ketu	Grupet e synuara: ⇒ Komuniteti ⇒ Biznesi ⇒ Pushteti Vendor	
Pjesemarrësit kryesore: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Biznesi ⇒ Komuniteti ⇒ Donatore	Kontributet kryesore ne projekt: ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje dhe bashkepunim ⇒ Ndergjegjesim dhe mirekuptim i Komunitetit ⇒ Mbeshtetje financiare	
Parakushtet: ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor, biznesit dhe komunitetit per te mbeshtetur kete ide ; ⇒ Mundesia financiare per ta aplikuar ⇒ Angazhim serioz per nje projekt cilesor ⇒ Terheqja e donatoreve	Faktoret e rrezikut: ⇒ Probleme ne shpronësime dhe kompensime ⇒ Buxhet i kufizuar; ⇒ Mungesa deshires se biznesit ose komunitetit per te qene partnere ⇒ Mungesa e donatoreve potenciale	
Shpenzimet e parashikuara: 1.000.000Euro ⇒ Shpenzime per shpronësime dhe kompensime te pronareve. ⇒ Preventivi i parashikuar per projekt-zbatimin		
Periudha e zbatimit: ⇒ 2005 - 2010	Periudha e ndikimit: ⇒ Pas implementimit te projektit.	

Nr. 11	Projekti: Q2:O1:PG2:p3: Zbatimi i studimit pjesor urban të zonës nga unaza e qytetit tek ish-deboja, deri tek autostrada.	Programi : Q2:O1:PG2: Ndertimet dhe rehabilitimet urbane të koordinuara nga bashkia dhe institucionet lokale.
Vlera XXX		
<u>Pershkrim i shkurtër i projektit:</u>		
<p>Rritja demografike dhe shtrirja e qytetit kërkojnë studime të hollësishme për një zhvillim të qendrueshëm urban, si dhe zbatimin e tyre nëpërmjet projekteve konkrete. Bashkia e Korces ka evidentuar të gjitha ato zona të cilat mund të quhen problematike, për një pjesë të tyre ekzistojnë edhe studime. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe zona të ish-deboje, për të cilën ekziston studim, por duhet të zbatohet. Mungesa e fondeve është një nga pengesat kryesore për zbatimin e tij. Vonesat në zbatimin e këtij studimi do të çojnë në popullimin pa kriter të kësaj zone, ku mungon infrastruktura e nevojshme për një jetesë normale. Zhvillimi i saj, do të mundësojë jo vetëm krijimin e një zone moderne, por dhe hapjen e bizneseve të reja, të cilat do të kontribuonin në gjithë këtë proces të vështirë. Ekzekutimi i këtij studimi do të bëhet i mundur nëpërmjet bashkëpunimit me komunitetin e biznesit dhe me atë të ndërtimit në vecanti, si dhe me të gjitha institucionet e tjera për sigurimin e shërbimeve të nevojshme.</p>		
Rezultatet e pritshme:		Grupet e synuara:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Sigurimi i një bashkëpunimi midis Qeveria Bashkiake, biznesit vendas, dhe institucioneve përgjegjëse për shërbime të ndryshme ⇒ Zhvillimi normal dhe i qendrueshëm i kësaj zone të qytetit ⇒ Krijimi i një hapësire të re për zhvillimin e bizneseve të reja ⇒ Permirësimi i jetesës së qytetareve 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Komuniteti ⇒ Institucionet e ndryshme ⇒ Bizneset ⇒ Pushteti Vendor
Pjesëmarrësit kryesorë:		Kontributet kryesore në projekt:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Institucionet ⇒ Bizneset ⇒ Donatore 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Bashkëpunim institucional ⇒ Bashkëpunim me bashkinë ⇒ Mbeshtetje financiare
Parakushtet:		Faktoret e rrezikut:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Hapësira ligjore të përcaktuara ⇒ Terheqja e interesit të institucioneve, biznesit dhe donatoreve për të financuar këtë projekt 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mungesa e një bashkëpunimi institucional ⇒ Buxheti i kufizuar
Shpenzimet e parashikuara:		
⇒ 400.000 Euro		
Periudha e zbatimit:		Periudha e ndikimit:
⇒ 2005 - 2010		⇒ Pas 2005

Nr. 12	Projekti : Q2:O1:PG2:p4: Ndërtimi i linjave të reja të kanalizimit të ujerave të zeza.	Programi : Q2:O1:PG2: Ndërtimet dhe rehabilitimet urbane të koordinuara nga bashkia dhe institucionet lokale.
Vlera XXXX	<u>Pershkrim i shkurtër i projektit:</u>	
<p>Qyteti i Korces ka qene qyteti i zbatimit te shume projekteve pilot, te cilat kane qene te nje suksesi te vecante. Vazhdimesi e kesaj eksperience do te jete edhe projekti i ndertimit te linjave te reja te kanalizimit te ujerave te zeza. Linjat ekzistuese, jane shume te vjetra dhe te amortizuara dhe si te tilla shkaktojne shume probleme, nepermjet carjes se tyre, e te tjera. Nje problem shume shqetesues eshte derdhja e ketyre ujerave te zeza ne vende te hapura (fusha, etj), duke ndotur keshtu ambientin e zones ku ato derdhen. Per zgjidhjen e ketij problemi, projekti parashikon edhe vendosjen e nje impianti te perpunimit te ujerave te zeza. Duhet theksuar qe ky eshte nje projekt ambicioz, i cili ka terhequr edhe vemendjen e donatoreve. Pjese shume e rendesishme e ketij projekti eshte transparenca ndaj komunitetit dhe ndergjegjesimi i tij per ta bere te kuptoje rendesine e ketij projekti, pamvaresisht nga problemet qe do te suportojte (prishja e rrugeve, etj)</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒ Shtrimi ne te gjithe qytetin i kanalizimeve te reja ⇒ Vendosja e impiantit te perpunimit te ujerave te zeza ⇒ Permiresimi i teknikave per mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet		Grupet e synuara: ⇒ Komuniteti ⇒ Pushteti Vendor
Pjesemarrësit kryesorë: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Institucionet ⇒ Donatore		Kontributet kryesore ne projekt: ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Bashkepunim institucional ⇒ Mbeshtetje financiare
Parakushtet: ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor, dhe i institucioneve te qytetit dhe i komunitetit per te mbeshtetur kete projekt ; ⇒ Ndergjegjesimi i qytetareve per te suportuar efektet negative gjate zbatimit te projektit ⇒ Terheqja e donatoreve		Faktoret e rrezikut: ⇒ Mosbashkepunim midis institucioneve dhe Pushtetit Lokal ⇒ Mosbashkepunim i komunitetit ⇒ Mungesa e donatoreve potenciale
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 25,000,000 Euro		
Periudha e zbatimit: ⇒ 2005 - 2006		Periudha e ndikimit: ⇒ Pas 2006

Nr. 13	Projekti: Q2:O1:PG2:p5: Rehabilitimi i rrjetit shpërndarës të energjisë duke përfshirë edhe zonën industriale (Zemblak-Nënstacion-Kabinë)	Programi : Q2:O1:PG2: Ndertimet dhe rehabilitimet urbane te koordinuara nga bashkia dhe institucionet lokale.
Vlera XXXX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Gjate periudhes se tranzicionit, shume sherbime kane pasur probleme te ndryshme. Nje nga keto ka qene edhe ofrimi i energjise elektrike te qytetareve. Problemi kryesor dhe nje nga synimet e pushtetit lokal ishte shtrirja e rrjetit te tensionit te mesem per mbajtjen e parametrave optimale te tensionit ne qytet.</p> <p>Ne Zemblak, afer qytetit te Korces, ka perfunduar ndertimi i nenstacionit elektrik Projekti i cili eshte per tu zbatuar gjate ketij viti e ne vazhdim, eshte ai i shtrimit te rrjetit te tensionit te mesem nga Nenstacioni i zemblakut, ne te gjitha kabinat. Ky projekt perfshin gjithashtu edhe rinovimin e te gjitha kabinave, te cilat jane rreth 27. Zonat qe do te preken jane jo vetem lagjet e qytetit por edhe zona industriale, duke permiresuar keshtu ofrimin e sherbimit me energji elektrike si qytetareve ashtu edhe biznesit.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Permiresimi i rrjetit shperndares te energjise elektrik ne qytet ⇒ Sigurimi i energjise elektrike me parametrat optimale te tensionit ne qytet ⇒ Krijimi i kushteve te pershtatshme per zhvillimin e biznesit ⇒ Ofrimi i sherbimit sa me te mire qytetareve 	<p>Grupet e synuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Qytetaret ⇒ Bizneset 	
<p>Pjesemarresit kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ KESH ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Donatore 	<p>Kontributet kryesore ne projekt:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbeshtetje teknike dhe financiare ⇒ Mbeshtetje teknike dhe financiare ⇒ Mbeshtetje teknike dhe financiare 	
<p>Parakushtet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Rinovimi i kabinave elektrike ⇒ Krijimi i bashkepunimit midis, KESH-it dhe donatoreve 	<p>Faktoret e rrezikut:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mungesa e donatoreve 	
<p>Shpenzimet e parashikuara:</p> <p style="text-align: center;">⇒ 5,000,000 Euro</p>		
<p>Periudha e zbatimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ 2005 - 2006 	<p>Periudha e ndikimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pas 2005 	

Nr. 14 Vlera XXX	Perojkti: Q2:O1:PG3:p1: Informatizimi i të dhënave dhe i proceseve të punës në zyrat e Bashkisë.	Programi: Q2:O1:PG3: Modernizimi i bashkise dhe zyres se gjendjes civile
<p style="text-align: center;"><u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u></p> <p>Korça është një qytet prej afërsisht 84000 banorë. Stafi i Bashkisë është prej 123 vete. Aktualisht, me gjithë përpjekjet e drejtorive për të koordinuar punën midis tyre, për të ardhur në ndihmë komunitetit në një mënyrë dhe kohë sa më efektive, nuk mund të shmangen vonesat në zgjidhjen e problemeve dhe ngarkesat në punën e punonjësve. Kjo bën që qytetarët të humbasin kohën nëpërmjet drejtorit të ndryshme. Njëkohësisht është e vështirë të përcaktohet në moment nga punonjësit, personat fizikë ose juridikë, të cilët janë debitore ndaj Bashkisë për të përfituar nga shërbimet e nevojshme. Qëllimi i Bashkisë së Korçës është rritja e shërbimit ndaj qytetarëve duke përdorur një shërbim të shpejtë, modern dhe transparent të bazuar në ligjet ekzistues, në mënyrë që të ulët burokracinë dhe të rriten marrëdhëniet midis bashkisë dhe qytetarëve. Bashkia e Korçës për të arritur këto objektiva mendon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të krijojë një sistem të ri të shërbimit ndaj qytetarëve. - Krijimi i një sistemi modern dhe të lehtë për përdorim nga qytetarët dhe personeli i bashkisë. <p>Për të mbështetur vizionin e saj bashkia e Korçës ka për synim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përqendrojë të gjitha proceset e saj në lidhje me kërkesat e qytetarëve të Korçës në një sistem të vetëm kompjuteristik - Të arrijë një kontroll të suksesshëm nëpërmjet një sistemi transparent - Të rrisë efikasitetin e proceseve duke përdorur praktikën me të mira në këtë fushë në bazë të një sistemi kompjuteristik. <p>Lidhja në rrjet do të përfshijë të paktën 45 kompjutera. Në këtë mënyrë programi i ri do të përmbushë kërkesat të bazuara në pjesën hardware dhe në mënyrën e programimit. Programi i ri nuk duhet të shifet vetëm si një program por si një sistem i tërë që do të sjellë një mënyrë të re operimit në bashki. Kjo do të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në ekzekutimin dhe efikasitetin e proceseve të ndryshme</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒ Rritje të cilësive dhe shpejtësisë në vendimmarrje ⇒ Monitorim më të mirë të procesit financiar dhe të atij funksional ⇒ Aplikim më efektiv të investimeve ⇒ Përmirësim të kontrollit dhe të planifikimit të brendshëm ⇒ Standartizimin e informacionit dhe rritjen e përgjegjësisë të punonjësve ⇒ Përmirësim të komunikimit me popullin, departamentet, sektorët etj. ⇒ Krijimin e kushteve më komode të punës të punonjësve të saj.		Grupet e synuara: ⇒ Bizneset e qytetit ⇒ Qytetarët ⇒ Punonjësit e Pushteti Vendor
Pjesëmarrësit kryesorë: ⇒ Pushteti Vendor dhe DHTI ⇒ Donatorët		Kontributet kryesore në projekt: ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike
Parakushtet: ⇒ Interesi i Qeverisë Bashkiake për ta mbështetur ⇒ Dëshira e donatorëve për të dhënë mbështetje financiare dhe asistencë Bashkisë ⇒ Projekt cilesor		Faktorët e rrezikut: ⇒ Buxheti i kufizuar; ⇒ Mungesa e donatorëve potencialë

Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 150,000 Euro	
Periudha e zbatimit: ⇒ Nje vit 2005	Periudha e ndikimit: ⇒ Pas vitit 2005.

Nr. 15	Projekti: Q2:O1:PG3:p2: Informatizimi i Zyres se Gjendjes Civile.	Programi: Q2:O1:PG3: Modernizimi i bashkise dhe zyres se gjendjes civile
Vlera XXX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Zhvillimi me ritme te shpejta i qytetit, kerkon ofrime sa me te shpejta dhe cilesore te sherbimeve ndaj qytetareve. Eshte nje problem i vazhdueshem, sherbimi i ofruar ndaj qytetareve. Praktika e perditshme e te gjitha institucioneve ne qytet, eshte sherbimi ne baze te certifikatave te ndryshme. Kjo sjell, krijimin e rradheve te gjata, te perditshme, te qytetareve ne dyert e zyres se Gjendjes Civile, duke shtuar keshtu, pakenaqesine e tyre ndaj sherbimeve te ofruara nga Bashkia. Puna e punonjeseve te Gjendjes Civile eshte shume e veshtire per shkak te regjistrave shume te vjeter (te krijuar qe ne vitin 1974) dhe fluksit te madh te njerezve. Informatizimi i Zyres se Gjendjes Civile, eshte nje domosdoshmeri per te zgjidhur te gjitha problemet e siperpermendura. E gjithë praktika e informatizimit te kesaj zyre, eshte e bazuar ne ligjin per informatizimin e zyrave te gjendjeve civile, dhe kerkon angazhimin e disa personave,(te cilet mund te jene te punesuar te perkohshem, ne baze te nje kontrate) pajisjen e kesaj zyre me disa kompjutera, baze materiale te nevojshme, etj. Pergatitjen e ketyre personave/trajnimin e tyre, do ta bejne punonjes te Bashkise.</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒ Hedhjen e te gjitha te dhenave qe jane ne regjistrat egzistues, ne programet e duhura ne kompjuter ⇒ Ofrimi i shpejte i sherbimeve ndaj qytetareve ⇒ Lehtesimi i punes se punonjeseve te zyres se gjendjes civile		Grupet e synuara: ⇒ Komuniteti ⇒ Pushteti Vendor
Pjesemarresit kryesore: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Donatore,		Kontributet kryesore ne projekt: ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike
Parakushtet: ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor dhe i donatoreve per te mbeshtetur kete ide ⇒ Angazhim serioz per nje projekt cilesor		Faktoret e rrezikut: ⇒ Buxhet i kufizuar ⇒ Mungesa e donatoreve potenciale
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 8.000 Euro		
Periudha e zbatimit: ⇒ Nje vit 2005		Periudha e ndikimit: ⇒ Gjate vitit 2005 e ne vazhdim.

Nr. 16	Projekti: Q2:O1:PG3:p3: Krijimi I nje arkive kompjuterike dhe nje programi kompjuterik per mbajtjen e te gjithë adresave per qytetin e Korçes	Programi: Q2:O1:PG3: Modernizimi i bashkise dhe zyres se gjendjes civile
Vlera XXX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Qyteti i Korces eshte nje qytet me nje arkitekture te vecante, vecori e cila e ben ate te dallohet nga qytetet e tjera dhe qe i jep nje karakter turistik. Shtepite karakteristike , ndryshimet qe kane pesuar ato gjate ketij dhjete-vjecari si dhe ndertimet e reja, kane bere qe shume prej tyre te mos jene te identifikuara. Ka shume rruge ekzistuese , te cilat kane emertim te njejte, ose, nuk dihen kufijte e tyre. Rritja e qytetit ka sjelle shtimin e numrit te ndertimeve dhe rrugeve te reja. Per te gjitha keto eshte shume e nevojshme vendosja e tabelave ne rruge dhe numrave per cdo shtepi.</p> <p>Bashkia e Korces eshte ne procesin e studimit dhe te identifikimit te te gjitha rrugeve dhe shtepive. Nga ky studim, deri tani rezultojne rreth 300 rruge dhe 20000 shtepi. Realizimi i ketij projekti eshte nje element i zhvillimit urban. Sherbimet e ofruara ne qytet nga institucione te ndryshme, telekom, KESH, Ujesjelles, etj, hasin veshtiresi te shumta ne identifikimin e klienteve sipas adresave te tyre. Gjithashtu, zhvillimi i qytetit, kerkon pergatitjen e materialeve te ndryshme promocionale, (hartat, broshura, etj). Turiste apo investitore, duhet te pajisen me harta te qytetit, te cilat te kene vendodhjen e sakte te objekteve te ndryshme. Cdo studim tjetër per qytetin do te vihej ne dyshim ne qofte se do te bazohej ne te dhena jo te sakta.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme: ⇒ Realizimi i nje studimi konkret qe do te krijojte nje baze te qendrushme te dhenash ⇒ Pajisja e cdo rruge apo ndertese me tabelat perkatese, emertim ose numer. ⇒ Permiresimi i imazhit te qytetit duke drejtuar zhvillimin e tij sipas standarteve europeane</p>	<p>Grupet e synuara: ⇒ Komuniteti ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Institucione te ndryshme ⇒ Bizneset ⇒ Turistet, vizitoret vendas apo te huaj qe vijne ne qytet</p>	
<p>Pjesemarresit kryesore: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Donatore ⇒ Bizneset Vendore</p>	<p>Kontributet kryesore ne projekt: ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje dhe bashkepunim</p>	
<p>Parakushtet: ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor dhe biznesit per te mbeshtetur kete ide ; ⇒ Studim paraprak i situates</p>	<p>Faktoret e rrezikut: ⇒ Burimet financiare te pamjaftueshme</p>	
<p>Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 25,000 Euro</p>		
<p>Periudha e zbatimit: ⇒ Nje vit 2005</p>	<p>Periudha e ndikimit: ⇒ Pas vitit 2005.</p>	

Nr. 17	Projekti: Q2:O1:PG4:p1: Krijimi i hartave dixhitale të rrjeteve inxhinierike për çdo institucion që operon brënda Bashkisë.	Programi: Q2:O1:PG4: Permiresimi dhe modernizimi I shkembimit te informacionit ndermjet bashkise dhe institucioneve lokale.
Vlera XXX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Zhvillimi i qytetit eshte shumeplanesh. Frytet dhe te mirat e ketij zhvillimi jane te shumta dhe po qaq te shumta jane edhe problemet qe sjell pas ai. Keto probleme kane te bejne me nje mosbashkepunim te vazhdueshem me institucione te ndryshme, dhe me mungesen e informimit reciprok. Shembuj te tille jane rruget e qytetit, te cilat jane hapur disa here per punimet e institucioneve te ndryshme, ne kohe te ndryshme. (KESH, Ujesjelles, Telekom,etj). Fakti qe ato nuk disponojne harta te rrjeteve inxhinierike, ben qe te kete shume demtime ne rrjete te ndryshme per shkak te germimeve. Keto jane pasoja te cilat i vuan komuniteti, i cili mbetet per periudha te pacaktuara kohore pa energji elektrike, uje, apo linje telefonike. Shtrirja e qytetit, krijimi i lagjeve te reja, te cilat kerkojne rregullime, shtrirje te rrjeteve te ndryshme, kanalizime, telefonike, elektrike, etj, duhet plotesohet me harta te ketyre rrjeteve. Te dhenat e te gjitha institucioneve duhet te mblidhen dhe te konvertohen ne standartet e GIS, per te krijuar hartat dixhitale te rrjeteve inxhinierike te nevojshme. Ne baze te gjithë ketij procesi, qendron bashkepunimi midis institucioneve te interesuara, qe puna e bere ti rezistojë kohes.</p>		
Rezultatet e pritshme:		Grupet e synuara:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbledhja e te dhenave dhe vendosja e nje bashkepunimi te vazhdueshem institucional ⇒ Krijimi i hartave dixhitale te rrjeteve inxhinierike ⇒ Permiresimi i punes ne zona te ndryshme ku nderhyet 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Institucionet e ndryshme ne qytet ⇒ Pushteti Vendor
Pjesemarresit kryesore:		Kontributet kryesore ne projekt:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Biznesi ⇒ Institucionet ⇒ Donatore 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Bashkepunim dhe mbeshtetje ⇒ Bashkepunimi institucional ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike
Parakushtet:		Faktoret e rrezikut:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor , dhe i institucioneve te qytetit per te mbeshtetur kete ide ; ⇒ Vendosja e bashkepunimit midis institucioneve ⇒ Angazhim serioz per nje projekt cilesor ⇒ Terheqja e donatoreve 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mosbashkepunim midis institucioneve dhe Pushtetit Lokal ⇒ Te dhena te pamjaftueshme ⇒ Mungesa e specialisteve per ta vene ne zbatim ⇒ Mungesa e donatoreve potenciale
Shpenzimet e parashikuara:		
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ 25.000 Euro <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pagesa e specialisteve qe do te punojne per hartimin e hartave dixhitale ⇒ Materiale, etj, per konkretizimin, e projektit. 		
Periudha e zbatimit:		Periudha e ndikimit:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ 2005 - 2007 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pas 2007

Nr. 18	Projekti: Q2:O2:PG1:p2: Rikonstruksioni i rrugëve kryesore te qytetit.	Programi: Q2:O2:PG1: Permiresimi i rrugëve urbane dhe sherbimeve publike ne bashkepunim me komunitetin.
Vlera XXX	<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>	
<p>Gjate ketij viti, Bashkia e Korces eshte duke punuar per hartimin e nje plani te detajuar per zhvillimin ekonomik te qytetit. Permiresimi i infrastruktures eshte nje nga problemet e qytetit qe ka nje influence te rendesishme ne zhvillimin e bizneseve te qytetit.</p> <p>Qyteti yne eshte duke u rritur ne menyre te vazhdueshme. Nevojiten nje numer i madh projektesh per zhvillim, kryesisht ato te infrastruktures. Po zhvillohen lagje te reja te cilat kane nevojte per krijimin e nje infrastrukture rrugore bashkekohore, dhe rrugte te tjera ne lagje te vjetra te qytetit kane nevojte per rikonstrukcion. Permiresimi i infrastruktures rrugore do te lehtesoje qarkullimin e automjeteve ne qytet. Permiresimi i infrastruktures rrugore te qytetit, eshte nje pjese e rendesishme e zhvillimit ekonomik, dhe e te gjitha strategjive qe u sherbejne qellimeve tona, duke krijuar kushte te pershtatshme si per biznese te reja, ashtu edhe per ato ekzistueset.</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒Permiresimi i infrastruktures se transportit ⇒Krijimi i kushteve sa me te mira per zhvillimin e bizneseve te reja ⇒Krijimi i kushteve per zhvillimin e bizneseve te reja		Grupet e synuara: ⇒ Komuniteti; ⇒ Businessi ⇒ Pushteti Vendor
Pjesemarrjesit kryesore: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Komuniteti ⇒ Donatore ⇒ Komuniteti i biznesit		Kontributet ne projekt: ⇒ Mbeshtetje teknike dhe financiare ⇒ Pune konkrete ne ndihme te punonjesve ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Bashkepunim
Parakushtet: ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor dhe komunitetit per te mbeshtetur kete ide ; ⇒ Deshira e donatoreve per ti ofruar asistencen teknike dhe financiare Bashkise ⇒ Projekte cilesore		Faktoret e rrezikut: ⇒ Buxheti i kufizuar; ⇒ Mungesa e donatoreve potenciale ⇒ Mungesa e komunitetit per te bashkepunuar
Spenzimet e llogaritura: ⇒ 315.000.000 leke		
Periudha e zbatimit: ⇒ Tre vite 2005-2008		Periudha e ndikimit: ⇒ Nga viti 2005.

Nr. 19	Projekti : Q2:O2:PG1:p3: Rehabilitimi i rrugëve dhe trotuareve me kalldrëm në pjesën e vjetër të qytetit.	Programi: Q2:O2:PG1: Permiresimi i rrugëve urbane dhe shërbimeve publike në bashkëpunim me komunitetin.
Vlera XXX	<u>Pershkrim i shkurtër i projektit:</u>	
<p>Qyteti i Korçes mbart vlera të rëndësishme kulturore, historike etj. Momentet e veshtira nëpër të cilat është dashur të kalojmë, kanë pasur të pranishëm efekte negative të cilat rrezikojnë që gjurmët, objektet dhe traditat që shprehin këto vlera, të zbehen ose të humbasin. Një nga karakteristikat që e dallojnë qytetin e Korçes nga qytetet e tjera, janë shtepite karakteristike dhe rruget me kalldrëm në disa lagje të tij. Koha e gjatë, nderhyrjet e shumta për permiresimin e rrjeteve të ndryshme, kanë demtuar seriozisht kalldrëmet e Korçes por së bashku me to edhe traditën shumë vjeçare të grave korçare për të mbajtur ato pastër. Rruget e bukura me kalldrëm, tani janë të prishura, të mbuluara nga pluhuri në verë dhe balta në kohë me shi, gjë e cila veshtireson jetën e qytetareve. Me një investim të konsiderueshëm prej 50 milion lek, u bë i mundur zëvendësimi i kalldrëmit për një sipërfaqe prej 15000 m² kur mbeten për tu rehabilituar edhe kalldrëmi i një sipërfaqeje prej 4000 m². Ruajtja e vlerave historike, do të ndihmonte qytetin e Korçes për të ruajtur identitetin e vet, traditën e bukur për të mbajtur qytetin e pastër, do të ndihmonte në terheqjen e turistëve dhe në permiresimin e jetës së qytetareve.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme: ⇒ Ruajtja e traditave, vlerave kulturore dhe historike të qytetit ⇒ Ruajtja e imazhit të qytetit të Korçes si një qytet të vecantë ⇒ Terheqja e turistëve ⇒ Permiresimi i cilësisë së jetës së qytetareve</p>		<p>Grupet e synuara: ⇒ Komuniteti ⇒ Biznesi ⇒ Pushteti Vendor</p>
<p>Pjesëmarrësit kryesorë: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Pushteti Qendror ⇒ Bizneset ⇒ Donatore</p>		<p>Kontributet kryesore në projekt: ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike</p>
<p>Parakushtet: ⇒ Përcaktimi definitiv i zonës së mbrojtur historike të qytetit ⇒ Terheqja e donatoreve</p>		<p>Faktorët e rrezikut: ⇒ Buxhet i kufizuar ⇒ Mungesa e donatoreve</p>
<p>Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 3,000,000 Euro</p>		
<p>Periudha e zbatimit: ⇒ 2005 - 2010</p>		<p>Periudha e ndikimit: ⇒ Pas 2005</p>

Nr. 20	Projekti: Q2:O2:PG1:p4: Vendosja e ndriçuesve në të gjitha hapësirave publike të qytetit.	Programi: Q2:O2:PG1: Permiresimi i rrugeve urbane dhe sherbimeve publike ne bashkepunim me komunitetin.
Vlera XXX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Energjia elektrike, ka qene per nje periudhe te gjate kohore, pjese e rendesishme e problemeve qe ka kaluar dhe kalon qyteti i Korces. Nepermjet projekteve dhe bashkepunimit me donatore te ndryshem, eshte bere e mundur zbutja e ketij problemi. Qyteti rritet dhe zhvillohet me ritme me te shpejta se mundesite financiare qe ka Bashkia per ti paraprire ketij zhvillimi. Sigurimi i ndricimit te zonave te reja, larg qendres se qytetit, jo vetem do te sillte gjallerimin e jetes se qytetareve, zhvillimin e bizneseve te reja, por edhe sigurine e jetes se tyre. Iniciativat e Bashkise kane te bejne jo vetem me identifikimin e problemeve dhe te zonave qe kane nevojte per nderhyrje, por edhe te zbatimit te projekteve konkrete. Keshtu, eshte bere e mundur ndricimi i gjithë rrugeve te qytetit, duke realizuar keshtu ndricimin e rreth 60 % te qytetit, me perjashtim te zonave te reja te banimit, te cilat nuk kane ndricim te mjaftueshem dhe te unazes se qytetit, e cila nuk eshte e ndricuar.</p> <p>Rreth 500 ndricuesa, nevojiten per te zgjidhur problemin e ndricimit me energji elektrike ne keto zona. Realizimi i ketij projekti do te mundesohet me kontributin e Bashkise, donatoreve, biznesit dhe komunitetit.</p>		
Rezultatet e pritshme:		Grupet e synuara:
<p>⇒ Gjallerimi i jetes se komunitetit ne oret e vona ne zonat te cilat do te pajisen me ndricues</p> <p>⇒ Zhvillimi i bizneseve te reja, te cilat do te mund te zhvillojne aktivitetin edhe ne mbremje</p> <p>⇒ Shtimi i sigurise se jetes se qytetareve</p>		<p>⇒ Komuniteti</p> <p>⇒ Biznesi</p> <p>⇒ Pushteti Vendor</p>
Pjesemarresit kryesore:		Kontributet kryesore ne projekt:
<p>⇒ Pushteti Vendor</p> <p>⇒ Bizneset e zonave ku do te nderhyet</p> <p>⇒ Komuniteti I zonave ku do te nderhyet</p> <p>⇒ Donatore</p>		<p>⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike</p> <p>⇒ Bashkepunim dhe mbeshtetje</p> <p>⇒ Mbeshtetje me pune konkrete</p> <p>⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike</p>
Parakushtet:		Faktoret e rrezikut:
<p>⇒ Krijimi i nje partneriteti midis Pushtetit Vendor, Bizneseve dhe komunitetit.</p> <p>⇒ Ndergjegjesimi i qytetareve per te ruajtur investimin e bere</p> <p>⇒ Terheqja e donatoreve</p>		<p>⇒ Mosbashkepunim midis paleve te interesuara dhe Pushtetit Lokal</p> <p>⇒ Buxhet i kufizuar</p> <p>⇒ Mungesa e donatoreve</p>
Shpenzimet e parashikuara:		
⇒ 50,000 Euro		
Periudha e zbatimit:		Periudha e ndikimit:
⇒ 2005 - 2006		⇒ Pas 2006

Nr. 21	Projekti: Q3:O1:PG1:p1: Ndërtimi i ambienteve të reja për shtimin e hapsirave të mësimdhënjes dhe strehimit të studentëve në Universitetin e Korçës	Q3:O1:PG1: Rritja e cilësisë së mësimdhënjes.
Vlera XXX	Pershkrim i shkurtër i projektit:	
<p>Ekzistenca e Universitetit në qytetin e Korçës, është një avantazh në favor të zhvillimit ekonomik. Studentet, të cilët diplomohen në këtë universitet, janë ata të cilët punësohen në bizneset e qytetit. Në këtë mënyrë, një nivel cilësor i tyre, do të thotë ekzistenca e burimeve njëzore të nevojshme zhvillimit ekonomik. Aktualisht, ekzistenca e Universitetit, përballë me një sërë problemesh, të cilat shkaktohen nga ambientet e pamjaftueshme, në të cilat zhvillohet mesimi. Implementimi i këtij projekti do të thotë sigurimi i hapsirave të reja Universitetit dhe gjithë infrastruktures së nevojshme, si një nga faktorët që do të mundësojë ngritjen e nivelit të tij, në standartet e Universiteteve të Evropës. Nga ana tjetër, zgjerimi i ambienteve të mesimdhënies në Universitet, shtimi i degeve të reja dhe rrjedhimisht i studenteve, do të rritë autoritetin e këtij Universiteti, në rajon. Nga pikpamja e biznesit, do të shtojë fluksin e të ardhurave në qytet, si dhe do të rritë konkurrencën në tregun e punës.</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒ Permiresimi i kushteve të mesimdhënies ⇒ Shtimi i numrit të fakulteteve në Universitet ⇒ Rritja e cilësore e studenteve ⇒ Burime njëzore të mjaftueshme në funksion të zhvillimit ekonomik		Grupet e synuara: ⇒ Pedagoget e Universitetit ⇒ Studentet ⇒ Biznesi ⇒ Pushteti Vendor
Pjesëmarrësit kryesorë: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Pushteti Qendror ⇒ Bizneset ⇒ Donatore		Kontributet kryesore në projekt: ⇒ Miratim nga Këshilli Bashkiak. ⇒ Mbeshtetje financiare ⇒ Mbeshtetje financiare ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike
Parakushtet: ⇒ Regjistrimi i pronave të Pushtetit Vendor ⇒ Miratim në Këshillin Bashkiak për venien në funksion të Universitetit të një prej pronave të Bashkisë		Faktorët e rrezikut: ⇒ Mosmiratim nga Këshilli Bashkiak për mbeshtetje të këtij projekti ⇒ Buxhet i kufizuar ⇒ Mungesa e donatoreve
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 900.000 Euro		
Periudha e zbatimit: ⇒ 2005 - 2010		Periudha e ndikimit: ⇒ Pas ndërtimit të ambienteve të reja.

Nr. 22	Projekti: Q3:O2:PG1:p1:	Q3:O1:PG1:
Vlera XXX	Rehabilitimi fizik i te gjitha shkollave te arsimit parauniversitar ne qytet.	Rritja e cilësisë së mësimdhënjes.
<p align="center"><u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u></p> <p>Viti shkollor 2005-2006 filloi me kushte mjaft te mira mesimdhënie. Bashkia ka bere te mundur rikonstruksionin e nje sere shkollash si: Shkolla 9-vjecare „Mesonjetorja” Shkolla 9-vjecare „Sevasti Qirjazi” Shkolla 9-vjecare „Sotir Gura” Shkolla e Re e Sportit Shkolla e mesme e pergjithshme „Raqi Qirinxi” Kopshti Nr.5 Por ka edhe shume shkolla te arsimit 9-vjecar dhe ate te mesem, qe kane nevojë per nje rehabilitim fizik. Per vitin e ri shkollor 2006-2007, Bashkia do te nderhyje ne shkolla te tjera, te cilat kane nevojë per tu rikonstruktuar, kryesisht ne rrethime kompleksesh shkollash, rikonstruksion palestres, kryerjen e nje sere punimesh ne ambjentet e brendshme, etj. Kjo do te sherbeje per krijimin e kushteve sa me te mira te shkollave, ne menyre qe te rritet efektiviteti i mesimdhënies. Bashkia ka miratuar ne KRRT lejat e ndertimit per punimet e meposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rrethim i Kopshtit Nr.5 • Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare „Stavri Themeli” • Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare „Asdreni” • Rikonstruksion i palestres se shkolles se mesme „Raqi Qirinxi” • Rrethimi i kompleksit te shkollave ne rrugen „Ajet Gjindolli” <p>Ambjentet e mesimdhënies do te jene me te mira e me funksionale.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>⇒ Krijimi i kushteve sa me te mira te mesimdhënies</p> <p>⇒ Rritja cilesore e nxenesve</p> <p>⇒ Mjedise te pershtatshme per kryerjen e mesimit</p> <p>⇒ Frekuentim me i madh i shkollave nga nxenesit</p>		<p>Grupet e synuara:</p> <p>⇒ Stafi pedagogjik i shkollave</p> <p>⇒ Nxenesit</p> <p>⇒ Pushteti Vendor</p>
<p>Pjesemarrësit kryesore:</p> <p>⇒ Pushteti Vendor</p> <p>⇒ Donatore</p>		<p>Kontributet kryesore ne projekt:</p> <p>⇒ Miratim nga Keshilli Bashkiak.</p> <p>⇒ Mbeshtetje financiare e teknike</p> <p>⇒ Mbeshtetje financiare</p>
<p>Parakushtet:</p> <p>⇒ Interesi i Pushtetit Vendor, mesuesve dhe nxenesve per te mbeshtetur kete ide</p> <p>⇒ Dëshira e donatoreve per te dhene ndihme financiare</p>		<p>Faktoret e rrezikut:</p> <p>⇒ Buxhet i kufizuar</p> <p>⇒ Mungesa e donatoreve</p>
<p>Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 40.000 Euro</p>		
<p>Periudha e zbatimit:</p> <p>⇒ 2006 - 2007</p>		<p>Periudha e ndikimit:</p> <p>⇒ 2006 e ne vazhdim</p>

Nr. 23	Projekti: Q3:O3:PG1:p2: Ndërtimi i një kompleksi sportiv modern në zonën mes shkollave "Demokracia" dhe "Naum Veqilharxhi"	Programi: Q3:O3:PG1: Krijimi i kushteve për një arsimim cilësor parauniversitar.
Vlera XXX		
<p style="text-align: center;"><u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u></p> <p>Zhvillimi demografik i qytetit kerkon nje zhvillim urbanistik I cili do te zgjase. Ngritja e terreneve sportive ne keto zona te reja duket qe t'i perkase nje perspektive me te larget, per vete kushtet ekonomike ne te cilat ndodhet vendi yne. Idea per rehabilitimin e ketij kompleksi sportiv, lindi ne baze te nje vleresimi te bere nga Bashkia te numurit te madh te popullsise (25000 banore) dhe vecanerisht te te rinjve dhe nxenesve qe perfshin kjo zone. Kompleksi sportiv egzistues, ndodhet 4 km larg kesaj zone dhe te rinjte spotdashes e kane te veshtire te arrijne atje ne cdo kohe, ndersa femijet nuk kane nje kend lojnash ku te luajne. Ky projekt do te konsistoje konkretisht ne:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nje fushe volejboli; Dy fusha basketbolli; Nje fushe handbolli; - Nje fushe minifutbolli; Nje kend lojnash per femije; Dy gropa kercimi se gjati; - Nje kend gjimnastike <p>Ky projekt do te perfshije edhe mbjelljen e pemeve dhe vendosjen e stolave dekorative. Te rinjte perbejne nje element te rendesishem te segmentit social. Mirembajtja dhe vazhdueshmeria e projektit varet nga perkujdesi qe do te tregojne nxenesit dhe te rinjte, prandaj ne ndertimin e ketij kompleksi, do te kontribojne me pune fizike te rinjte te cilet do ta shfrytezojne ne interes te tyre. Paradite do te shfrytezohe nga nxenesit e shkollave dhe pasdite, nga te rinj te ndryshem kundrejt nje tarife simbolike qe do te perdoret per mirembajtjen e kompleksit</p>		
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>⇒Gjallerimi i jetes se zones rreth kompleksit</p> <p>⇒Terheqja e te rinjve per te kaluar kohen e lire</p> <p>⇒Krijimi i kushteve per sportistet e rinj</p>	<p>Grupet e synuara:</p> <p>⇒ Te rinjte qe banojne prane kompleksit</p> <p>⇒ Femijet,</p> <p>⇒ Gjithe komuniteti</p>	
<p>Pjesemarresit kryesore:</p> <p>⇒ Pushteti Vendor</p> <p>⇒ Bizneset e zones</p> <p>⇒ Komuniteti</p> <p>⇒ Donatore</p>	<p>Kontributet kryesore ne projekt:</p> <p>⇒Mbeshtetje financiare dhe teknike</p> <p>⇒Mbeshtetje financiare dhe teknike</p> <p>⇒Mbeshtetje me pune konkrete</p> <p>⇒Mbeshtetje financiare dhe teknike</p>	
<p>Parakushtet:</p> <p>⇒ Interesi i Pushtetit Vendor, komunitetit dhe biznesit per te mbeshtetur kete ide ;</p> <p>⇒ Dëshira e donatoreve dhe biznesit per te dhene mbeshtetje financiare</p> <p>⇒ Projekt cilesor</p>	<p>Faktoret e rrezikut:</p> <p>⇒ Buxhet i kufizuar;</p> <p>⇒ Mungesa e donatoreve potenciale</p>	
<p>Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 150,000 Euro</p>		
<p>Periudha e zbatimit:</p>	<p>Periudha e ndikimit:</p>	

⇒ 2005-2010	⇒ Pas ndertimit.
-------------	------------------

Nr. 24	Projekti: Q4:O1:PG1:p1: Ngritja e qendrës së informacionit mbi turizmin.	Programi: Q4:O1:PG1: Ngritja, në bashkëpunim me biznesin, e sistemeve për promovimin e potencialeve turistike të Korcës dhe zonës perreth.
Vlera XX	<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>	
<p>Qyteti i Korces eshte nje qytet me tradita historike dhe kulturore. Te gjithë ata qe vizitojne qytetin dhe vendet turistike rreth tij, largohen me pershtypjet me te mira per te dhe me nje dëshire per tu rikthyer. Mbresat jane te shumeaneshme, natyrore, kulturore, historike, etj. Ky qytet dhe rajoni ne te cilin shtrihet ofron nje infrastrukture te pershtatshme per zhvillimin e turizmit dhe te atij te konferencave dhe te aktiviteteve te ndryshme kulturore. Nje sere aktivitetesh jane bere tradite ne qytet. Por ajo qe i mungon ketij zhvillimi, eshte nje marketing profesional. Per kete arsye, do te krijohet nje zyre/qender rajonale e informacionit mbi turizmin me kontributin e bizneseve te turizmit, te cileve bashkia u ve ne dispozicion nje ambient. Kjo qender do te ofroje informacion rreth venedeve turistike, sherbimeve te ofruara atje nga restorante, hotele, cmimet apo ofertat e tyre, etj. Do te krijohen materiale informative me informacione per biznese te vecanta si dhe kalendare vjetore te aktiviteteve kulturore. Kjo te shtonte fluksin e turisteve, qofte te atyre te turizmit tradicional ashtu edhe te atyre te turizmit kulturor.</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒ Zhvillimi i nje marketingu profesional mbi turizmin ⇒ Terheqja e turistëve. ⇒ Krijimi i kushteve per nje bashkepunim konkret Bashki-Biznes per zhvillimin e turizmit		Grupet e synuara: ⇒ Bizneset e turizmit
Pjesemarresit kryesore: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Bizneset e turizmit te rajonit ⇒ Donatore		Kontributet kryesore ne projekt: ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike
Parakushtet: ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor dhe biznesit per te mbeshtetur kete ide ⇒ Projekt cilesor dhe i aplikueshem		Faktoret e rrezikut: ⇒ Mungesa e nje bashkepunimi konkret bashki-biznes
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 20,000 Euro		
Periudha e zbatimit: ⇒ Nje vit 2005		Periudha e ndikimit: ⇒ Pas vitit 2005.

Nr. 25	Projekti: Q4:O1:PG1:p2: Botimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore dhe atij të aktiviteteve sportive.	Programi: Q4:O1:PG1: Ngritja, në bashkëpunim me biznesin, e sistemeve për promovimin e potencialeve turistike të Korcës dhe zonës perreth.
Vlera XX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Zhvillimi i turizmit eshte nje nga drejtimet e parashikuara nga komuniteti i biznesit per zhvillimin e qytetit. Ne bashkepunim me bizneset e turizmit, Bashkia e Korces ka ndermare projekte te ndryshme per promovimin dhe zhvillimin e tij, per terheqjen e interesit te turistevendash dhe te huaj, nje forme e cila mendojme qe do te ndihmoje shume bizneset e turizmit. Qendra e informacionit per turizmin, apo agjensi te ndryshme turistike do te shperndajne materiale turistike, guida, harta etj. Pjese e ketij procesi do te jete dhe hartimi i kalendareve vjetore te aktiviteteve kulturore dhe sportive, me qellim terheqjen e interesit te turistevendash per te vizituar qytetin e Korces. Keto kalendare do te pergatiten nga Sektori i kultures dhe i Sportit prane Bashkise ne bashkepunim me te gjitha institucionet e tjera qe mund te ofrojne kete lloj informacioni. Keto kalendare mund te shperndahen ne formen e fletepalosjeve te bashkangjitura materialeve te tjera.</p>		
Rezultatet e pritshme:	Grupet e synuara:	
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Promovimi i aktiviteteve kulturore te qytetit ⇒ Rritja e numrit te turistevendash dhe te huaj ne qytet ⇒ Permirsimi i procesit te promovimit te qytetit ne favor te zhvillimit te biznesit ⇒ Shtimi i numrit te aktiviteteve kulturore dhe sportive duke e bere me atraktiv qytetin 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Turistet vendas dhe te huaj ⇒ Bizneset e turizmit 	
Pjesemarrjet kryesore:	Kontributet kryesore ne projekt:	
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Institucionet e ndryshme kulturore dhe sportive ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Agjensite turistike ⇒ Donatore 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbeshtetje teknike, bashkepunim me Pushtetin Vendor ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Bashkepunim me Pushtetin Vendor ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike 	
Parakushtet:	Faktoret e rrezikut:	
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbledhja e te gjitha informacionit te nevojshem ⇒ Krijimi i bashkepunimit midis Pushtetit Vendor dhe bizneseve turistike 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mungesa e bashkepunimit midis institucioneve per krijimin e te dhenave 	
Shpenzimet e parashikuara:		
⇒ 2.000 Euro		
Periudha e zbatimit:	Periudha e ndikimit:	
⇒ 2005 - 2006	⇒ Pas 2005	

Nr. 26	Projekti: Q4:O2:PG1:p1: Rehabilitimi i ambjenteve të brëndëshme dhe sitemeve të punës të Teatrit "A.Z.Cajupi".	Programi: Q4:O2:PG1: Promovimi cilësor i historisë dhe kulturës nëpërmjet institucioneve publike.
Vlera XXXX	<p align="center"><u>Pershkrim i shkurtër i projektit:</u></p> <p>Teatri “ A.Z.Cajupi”, është institucion unik i cili ka keto karakteristika dhe percaktime: tek ai janë gershetuar me njëra-tjetren nevojat shpirtërore të shoqërisë në gjithë rajonin. Është krijuar 40 vjet më parë por si një teater profesional, ka një eksperiencë prej 50 vjetësh. Pas ndimit të sistemit, Teatri i Korçës ka kapërcyer shumë vështirësi, në sajë të punës dhe pasionit të artistëve. Duke qenë i vetmi institucion, i cili ka një aktivitet profesional dhe të përhershëm, është përgjegjësi e tij, të plotësojë nevojat shpirtërore, artistike të të gjithë komunitetit brenda dhe jashtë rajonit. Që në vitin 2000, ky institucion dhe Bashkia kanë organizuar Komedinë Teatrale ndërkombetare “Ballkan 2000”. Është një spektakël i përvitshëm. Në ndërtimin e këtij teatri, parashikohen të zhvillohen shumë aktivitete dhe premiera të ndryshme.</p> <p>Por, institucioni nuk ka kushte të përshtatshme për të ofruar spektakle të suksesshme. Ndërtimi ka qenë e ndërtuar që në vitin 1957, pra, është shumë e rëndësishme rikonstruksioni i saj, si një investim shumë i rëndësishëm në shërbim të zhvillimit të kulturës.</p>	
Rezultatet e pritshme: ⇒Përmirësimi i kushteve të teatrit për artistët ⇒Krijimi i kushteve të mira për spektatorët ⇒Krijimi i kushteve për ringjalljen e jetës kulturore të qytetit		Grupet e synuara: ⇒ Artistë ⇒ Komuniteti ⇒ Pushteti Vendor
Pjesëmarrësit kryesorë: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Pushteti Qendror ⇒ Donatore		Kontributet kryesore në projekt: ⇒ Mbeshtetje teknike dhe financiare ⇒ Mbeshtetje financiare ⇒ Mbeshtetje financiare
Parakushtet: ⇒ Interesi i Pushtetit Lokal dhe komunitetit për të mbështetur këto ide ; ⇒ Dëshira e donatoreve për të dhënë mbështetje financiare dhe asistencë Bashkise; ⇒ Projekt cilësor		Faktoret e rrezikut: ⇒ Buxhet i kufizuar; ⇒ Mungesa e donatoreve potenciale
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 100,000 Euro		
Periudha e zbatimit: ⇒ Një vit 2005-2006		Periudha e ndikimit: ⇒ Pas vitit 2005.

Nr. 27	Projekti: Q4:O2:PG1:p2: Rikonstruksioni i Pazarit te vjeter	Programi: Q4:O2:PG1: Promovimi cilësor i historisë dhe kulturës nëpërmjet institucioneve publike.
Vlera XX	<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>	
<p>Pazari i vjeter i Korces eshte nje nga monumentet e kultures me te njohurat ne rajon. Mbart me vete vlera shume te rendesishme historike, duke qene ne shekullin e 18, si nje faktor i lulezimit ekonomik te qytetit te Korces. Vlerat historike te tij jane te pacmuara, por ne kete moment dhe kryesisht gjate periudhes se tranzicionit, ato sa po vijne dhe po zbehen. Kjo per shkak te demtimit rende te ndertesave brenda tij, fasadave te shkateruara, etj. Vitet e fundit, Bashkia eshte perpjekur te beje nje rikonstruksion te kanalizimeve dhe kalldremit tradicional, por mbetet ende shume per te bere. Ekziston ne studim dhe nje projekt zbatim per rehabilitimin e plote te ketij monumeti kulture.</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒ Kthimi ne identitet i Pazarit te Vjeter te qytetit ⇒ Zhvendosja e tregut ekzistues ne nje hapësire tjeter, per tu dhene frymemarrje bizneseve brenda ndertesave te pazarit ⇒ Ndergjegjesimi i pronareve te ndertesave, per te investuar si partnere ne kete projekt, per rregullimin e fasadave ⇒ Shtimi I elementeve, si pjese e atraksioneve turistike ne qytet.		Grupet e synuara: ⇒ Qytetaret ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Bizneset
Pjesemarrësit kryesore: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Komuniteti ⇒ Donatore		Kontributet kryesore ne projekt: ⇒ Mbeshtetje teknike dhe financiare ⇒ Ndihma e komunitetit ne pune konkrete ⇒ Mbeshtetje financiare. Ekspertize
Parakushtet: ⇒ Identifikimi i fondeve te nevojshme dhe I donatoreve te mundshem		Faktoret e rrezikut: ⇒ Mungesa e fondeve te nevojshme
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 1,000,000 Euro		
Periudha e zbatimit: ⇒ 2005 - 2010		Periudha e ndikimit: ⇒ Pas 2010

Nr. 28	Projekti: Q4:O2:PG1:p3:	Programi: Q4:O2:PG1:
Vlera XXX	Ndertimi i Muzeut Historik te qytetit.	Promovimi cilësor i historisë dhe kulturës nëpërmjet institucioneve publike.
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Qyteti i Korces eshte nje nga qytetet me nje trashegimni kulturore mjaft te madhe, e cila pasqyrohet jo vetem ne traditat e popullit por edhe ne institucione te ndryshme kulturore qe e perfaqesojne. Muzeume te ndryshme ndodhen ne qytet, por ajo qe i mungon eshte pikerisht Muzeu Historik. Populli yne ka vlera te mjaftueshme per te pasqyruar historine e tij. Ky muzeum do te jete nje bagazh vlerash dhe faktesh qe do tu mesoje brezave te rinj per te kaluaren, do tu rikthejne brezave te tjere momentet me te rendesishme te zhvillimit, si nje force per te ecur perpara. Ne te njejten kohe, do te ishte nje faktor me teper per te terhequr vizitore dhe turistete te ndryshem per tu njohur me historine e qytetit tone.</p> <p>Realizimi i ketij projekti do te ishte mjaft i mundur, duke organizuar kapacitetet intelektuale qe ka qyteti i Korces, per te krijuar pjesen qe mungon te bazes materiale. Andertimi i tij do te behet ne nje hapësire te vene ne dispozicion nga Bashkia, ose do te shfrytezohet nje ndertese ekzistuese, prone e Bashkise.</p>		
Rezultatet e pritshme:		Grupet e synuara:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Zgjerimi i bazes kulturore te qytetit. ⇒ Krijimi i nje elementi te rendesishem shprehes i historise se popullit tone ⇒ Bashkepunimi i te gjitha institucioneve dhe intelektualeve per krijimin e muzeut ⇒ Zgjimi i interesit te te rinjve per te njohur me mire historine e vendit te tyre ⇒ Shtimi i elementeve, si pjese e atraksioneve turistike ne qytet. 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Qytetaret ⇒ Intelektualet ⇒ Universiteti ⇒ Historianet ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Bizneset turistike
Pjesemarresit kryesore:		Kontributet kryesore ne projekt:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Historiane ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Pushteti Qendror ⇒ Donatore 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mbeshtetje intelektuale ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike. Miratim nga Keshilli Bashkiak ⇒ Mbeshtetje financiare ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike. Ekspertize
Parakushtet:		Faktoret e rrezikut:
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Identifikimi i fondeve te nevojshme dhe i donatoreve te mundshem ⇒ Percaktimi i sheshit te ndertimit dhe miratimi i tij ne KRRT, ose i nderteses dhe miratimi ne Keshillin Bashkiak per perdorim ⇒ Terheqja e intelektualeve dhe historianeve ne kete projekt 		<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Mungesa e fondeve te nevojshme
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 250.000 Euro		
Periudha e zbatimit:		Periudha e ndikimit:
⇒ 2005 - 2010		⇒ Pas 2010

Nr. 29	Projekti: Q5:O1:PG1:p1: Rehabilitimi i fushës ekzistuese të mbledhjes së mbetjeve urbane.	Programi: Q5:O1:PG1: Trajtimi i mbetjeve urbane sipas parametrave ligjor.
Vlera XXXX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Pas realizimit te studimit te fizibilitetit dhe percaktimit dhe miratimit te fushes se re te mbledhjes se mbeturinave urbane, nje problem i cili behet cdo dite e me shqetesues, eshte pikerisht rehabilitimi i fushes ekzistuese te mbetjeve urbane. Kjo fushe, ndodhet mbi bazenin ujembajtes te qytetit. Hedhjet e mbeturinave pa kriter dhe mosperpunimi i tyre, ben qe te ndotet mjedisi dhe rrezikon ndotjen e ujit te pijshem. Ky problem sa vjen dhe behet me evident kryesisht per zonat e banuara ne afersi te kesaj fushe. Shume problematike jane edhe gazrat e cliruara si shkak i ketyre mbeturinave. Ky projekt parashikon jo vetem pastrimin e kesaj fushe nga mbetjet, por edhe kthimin e saj ne nje zone te gjelberuar. Ne kete menyre do te kontribohet ne menyre te ndjeshme mbi cilesine e ajrit dhe pastertine e mjedisit.</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒ Pastrimi i fushes ekzistuese nga mbeturinat ⇒ Ruajtja e mjedisit nga ndotja ⇒ Parandalimi i ndotjes se ujit te pijshem ⇒ Shtimi i zonave te gjelberuara ne qytet		Grupet e synuara: ⇒ Qytetaret ⇒ Pushteti Vendor
Pjesemarrësit kryesore: ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Donatore		Kontributet kryesore ne projekt: ⇒ Mbeshtetje teknike dhe financiare ⇒ Mbeshtetje financiare
Parakushtet: ⇒ Identifikimi i fondeve te nevojshme dhe I donatoreve te mundshem ⇒ Hartimi i nje projekti te hollesishem per rehabilitimin e kesaj fushe nga specialistet perkates		Faktoret e rrezikut: ⇒ Mungesa e fondeve te nevojshme
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 1.000.000 Euro		
Periudha e zbatimit: ⇒ 2005 - 2010		Periudha e ndikimit: ⇒ Pas 2010

Nr. 30	Projekti : Q5:O1:PG1:p2:	Programi: Q5:O1:PG1:
Vlera XXXX	Ndërtimi i fushës së re të depozitimit dhe përpunimit të mbetjeve urbane.	Trajtimi i mbetjeve urbane sipas parametrave ligjor.
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Mbrojtja e mjedisit po behet gjithnje e me shume nje problem prioritar per tu zgjidhur. Permiresimi i cilesise se jeteses se qytetareve eshte i lidhur ngushte me projekte te vazhdueshme per sigurimin e nje mjedisi te paster e te shendetshem. Nisur nga kjo, nje nga menytrat me te vlefshme, eshte permiresimi i teknikave te menaxhimit te mbetjeve urbane. Ndertimi i nje fushe te re te mbledhjes dhe përpunimit të mbeturinave urbane, e cila do ti sherbeje gjithë Prefektures se Korces, eshte nje projekt, per te cilet Bashkia e Korces po bashkepunon me eksperte dhe donatore nderkombetare. Aktualisht, ka perfunduar studimi i fizibilitetit dhe eshte miratuar nga KRRTSH sheshi per ndertimin e fushes se re, e cila do te jete ne Fshatin Maliq. Ketu do te vendoset edhe nje impiant i përpunimit të mbetjeve urbane. Eshte vendosur nje marreveshje bashkepunimi (memorandum mirekuptimi) midis Bashkive dhe Komunave te Prefektures. Aplikimi i ketij projekti, do te zgjidhe problemin e ndotjes se mjedisit ne qytet dhe do ti sherbeje gjithë prefektures.</p>		
Rezultatet e pritshme:		Grupet e synuara:
⇒ Ndertimi i fushes se mbledhjes se mbeturinave urbane sipas standarteve te kohes ⇒ Përpunimi i mbeturinave urbane ⇒ Permiresimi i teknikave per mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet ⇒ Perdorimi i fushes nga te gjitha bashkite dhe komunat e prefektures		⇒ Komuniteti i qytetit te Korces ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Pushteti Vendor i Qarkut
Pjesemarresit kryesore:		Kontributet kryesore ne projekt:
⇒ Pushteti Vendor ⇒ Donatore		⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike
Parakushtet:		Faktoret e rrezikut:
⇒ Krijimi i nje marreveshjeje bashkepunimi midis bashkive dhe komunave ⇒ Terheqja e donatoreve		⇒ Mungesa e donatoreve potenciale
Shpenzimet e parashikuara:		
⇒ 20,000,000 Euro		
Periudha e zbatimit:		Periudha e ndikimit:
⇒ 2005 - 2007		⇒ Pas 2005

Nr. 31	Projekti: Q5:O2:PG2:p1: Reabilitimi i gjelbërimit në rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit.	Programi: Q5:O2:PG2: Permiresimi i nivelit të gjelbërimit të rrugëve dhe shesheve publike.
Vlera XXX		
<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>		
<p>Krijimi i nje sistemi te stabilizuar demokratik ne Shqiperi, kerkon nje qeverisje sa me eficiente. Eshte e nevojshme perfshirja e qytetareve ne procesin e marrjes se vendimeve dhe zbatimin e projekteve te perbashketa. Sipas kesaj situate, drejtuesit e rajoneve te Korces dhe komuniteti kane vendosur te punojne se bashku ne projekte te cilat do ti sjellin me afer dhe do te aftesojne qytetaret te marrin pjese ne kete proces, duke i ndergjegjesuar per menyren e shpenzimit te fondeve dhe cilesine e punimeve. Implementimi i ketij programi, do te promovojte partneritetin publik-privat ne lagjet e Korces.</p> <p>Ka nje sere hapësirash ne Korçe ne lagje te ndryshme, kryesisht ne ato periferike. Keto jane lagje, ku dominojne kryesisht femije dhe njerëz te varfer. Sipas projektit eshte planifikuar qe keto hapësira te perdoren si parqe dhe kend lojnash per femije. Aktualisht, ato jane te ne gjendje te keqe, ku ne vere eshte plot me pluhur dhe ne shi, me balte. Shpeshhere behen depozita te pleherave te qytetareve, duke rrezikuar shendetin e tyre. Tashme ekzistojne eksperienca pozitive duke i bere keto lloj projektesh me nje rendesi te vecante.</p>		
Rezultatet e pritshme:	Grupet e synuara:	
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Te zgjoje interesin per ndryshimin e nevojshem ne sherbimet e ofruara ⇒ Zgjidhje programeve per komunitetin ⇒ Sugjerime dhe ide se si mund te behet efficient dhe nje buxhet i kufizuar ⇒ Edukimi i komunitetit mbi menytrat dhe arsyen e marrjes se vendimeve 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Komuniteti; ⇒ Pushteti Vendor 	
Pjesemarrësit kryesore:	Kontributet ne projekt:	
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Donatore ⇒ Komuniteti 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Miratimi i Keshillit Bashkiak per hapësirat e gjelbera si prioritet investimesh. Mbeshtetje financiare ⇒ Identifikimi i donatoreve; ⇒ Mbeshtetja e komunitetit 	
Parakushtet:	Faktoret e rrezikut:	
<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Interesi i Pushtetit Vendor dhe Komunitetit per te mbeshtetur kete ide; ⇒ Dëshira e donatoreve per te mbeshtetur financiarisht dhe me asistencë projektin tone. ⇒ Te jene keto hapësira te gjelbera, prioritet per investime. 	<ul style="list-style-type: none"> ⇒ Buxheti i kufizuar; ⇒ Mungesa e donatoreve potenciale ⇒ Mungesa e interesit te komunitetit per te bashkepunuar 	
Shpenzimet e llogaritura:		
⇒ 300.000 Euro		
Periudha e implementimit:	Periudha e ndikimit:	
⇒ Dy vjet 2005-2007	⇒ Nga viti 2005.	

Nr. 32	Projekti : Q5:O3:PG1:p1: Krijimi i një sistemi për monitorimin gjatë gjithë vitit të cilësisë së ajrit të Qytetit.	Programi : Q5:O3:PG1: Prezantimi i nje sistemi per monitorimin e cilesise se ajrit ne qytet.
Vlera XX	<u>Pershkrim i shkurter i projektit:</u>	
<p>Studimi i cilesise se ajrit te qytetit te Korces realizuar nepermjet monitorimit te tij gjate gjithë vitit nga Drejtoria e Kujdesit Shendetesor Paresor korce ne bashkepunim me Inst. Shendetit Publik Tirane tregojne shifra me te larta se rekomandimet e OBSH per lendet e grimcuara ne suspension LGS dhe PM10. keto lende ndotese kane ne perberje te tyre pluhurin e ashper te rrugeve si dhe shkarkimet e automjeteve te ajer. Prania e ketyre lendeve te grimcara ne suspension mbi rekomandimet e OBSH vjen nga pluhuri i rrugeve, aktivitete ndertimore dhe per faktin qe Korca ka shume rruge te pa asfaltuara. Rruget egzistuese me gure dhe kalldre me nuk realizojne dot fshirje dhe larje nga subjektet administruese te pastrimit te qytetit. Lenia per nje kohe te gjate te rrugeve te Korces te demtuara dhe me gropa ka ndikimin e vet ne rritjen e LGS. Demtimet ne shendet jane kryesisht ne rruget e siperme te frymemarrjes, rinit, faringit, organet e te parit (sy). PM10 deperton edhe ne indin mushkeror dhe sjell demtim te indit alveolar duke shpene ne te grimcat e plumbit, kadmiumit dhe HAP (hidrokarbure aromatike policiklike) me pasoja bronkopati kronike.</p> <p>Kryerja e vazhdueshme e ketij studimi do te ndikojne ne institucionet pergjegjese per te nderhyre ne kohe per zgjidhjen e problemeve qe e shkaktojne.</p>		
Rezultatet e pritshme: ⇒ Ruajtja e nje ambienti te paster ⇒ Sigurimi i informacionit ne cdo periudhe mbi nivelin e ndotjes ⇒ Permiresimi i sherbimeve per te siguruar nje mjedis te paster		Grupet e synuara: ⇒ Komuniteti ⇒ Pushteti Vendor
Pjesemarresit kryesore: ⇒ Drejtoria e Kujdesit Shendetesor Paresor Korce ⇒ Pushteti Vendor ⇒ Instituti i Shendetit Publik Tirane ⇒ Donatore		Kontributet kryesore ne projekt: ⇒ Bashkepunim institucional ⇒ Mbeshtetje financiare dhe teknike ⇒ Bashkepunim Institucional ⇒ Mbeshtetje financiare
Parakushtet: ⇒ Krijimi i bazeve se te dhenave te nevojshme ⇒ Krijimi i nje bashkepunimi institucional ⇒ Krijimi i bazeve materiale te nevojshme		Faktoret e rrezikut: ⇒ Mosbashkepunim midis institucioneve lokale dhe kombetare ⇒ Vonesa ne ofrimin e sherbimeve per zgjidhjen e problemeve te ndryshme
Shpenzimet e parashikuara: ⇒ 5000 Euro		
Periudha e zbatimit: ⇒ 2005 - 2010		Periudha e ndikimit: ⇒ Pas 2005

